

RAPORTI VJETOR

2021
VJET



BPB

Banka e vendit tënd

PËRMBAJTJA

LETRA E DREJTORIT
TË BORDIT ... 05

BURIMET NJERËZORE
DHE TRAJNIMET ... 35

LETRA E KRYESHEFIT
EKZEKUTIV ... 07

MENAXHIMI I
RREZIKUT ... 41

STRUKTURA
ORGANIZATIVE ... 09

PAJTUESHMËRIA ... 45

ZHVILLIMET EKONOMIKE
DHE INDUSTRIA
BANKARE ... 13

SIGURIA E INFORMACIONIT
DHE MBROJTJA E TË
DHËNAVE PERSONALE ... 49

PERFORMANCAFINANCIARE
E BANKËS ... 17

PËRGJEGJËSIA
SOCIALE ... 53

ZHVILLIMET NË
BIZNES ... 23

PASQYRAT
FINANCIARE ... 57

ZHVILLIMI I PRODUKTEVE
DHE TEKNOLOGJIA
INFORMATIVE ... 31

LETRA E DREJTORIT TË BORDIT



Ansis Grasmanis
DREJTORI I BORDIT

Të nderuar lexues,

Ekonomia globale ka shënuar një rikthim drejt një normalizimi të ri në vitin 2021, pavarësisht se bota ende po vazhdon të përballet me pandeminë. Kosova po rikthehet nga recesioni i vitit 2020, falë një rimëkëmbje më të shpejtë se sa që pritej përgjatë vitit të fundit duke u ndihmuar nga lehtësimi i kufizimeve për qytetarët dhe bizneset në mbrojtje nga virusi Covid-19, fluksi më i lartë i vizitorëve nga diaspora, masat mbështetëse nga institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, si dhe aktiviteti më i shtuar ekonomik nga bizneset.

Raportet e fundit flasin për një rritje ekonomike rreth 10%. Kjo rritje pritet të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2022 edhe pse me një ritëm më të ulët krahasuar me 2021. Sektori bankar ka arritur të rrisë kreditimin në ekonominë e Kosovës me rreth 500 milion euro, duke shënuar kështu një rritje prej rreth 15%, derisa, viti 2021 për BPB-në ka shënuar njërin nga vitet më të suksesshme të operimit.

BPB demonstroi pozicionin e mirë në treg me një bazë të qëndrueshme të mbështetur nga parametrat kyç të ofrimit të shërbimeve bankare dhe kredimit, performancës financiare dhe menaxhimit të rrezikut.

Modeli i biznesit të bankës të fokusuar në kreditimin dhe mbështetjen financiare të mikrobizneseve, NVM-ve dhe klientëve individual ka rezultuar i suksesshëm edhe përgjatë vitit 2021 duke i shfrytëzuar avantazhet e veta në treg.

Në terma relativ, rritja e kreditimit nga BPB ka qenë mbi rritjen mesatare të tregut, duke qëndruar e vëmendshme në diversifikimin dhe kualitetin e portofolit që është përmirësuar përgjatë vitit. Depozitat e klientëve poashtu kanë shënuar rritje të qëndrueshme. Rezultatet financiare të BPB-së, pozicionimi në treg, rreziqet e kontrolluara, stafi dhe infrastruktura adekuate rezultuan në përmbylljen e një viti të jashtëzakonshëm.

Falë kontributit të të gjitha linjave të biznesit, BPB e ka mbyllur vitin me 7.9 milion euro profit, derisa

vazhdon të ju shërbejë dhjetëra mijëra klientëve aktiv në të gjithë Kosovën.

Përballja me pandeminë ka vërtetuar se Banka për Biznes është mjaftueshëm e qëndrueshme për të përballuar goditjen nga krizat, duke sjellë fleksibilitetin e nevojshëm të klientët tanë. BPB është adaptuar me këtë mënyrë të re të jetesës, dhe po lëvizë me hapa të shpejtë drejt transformimit ku teknologjitë inovative kanë çuar drejt dixhitalizimit të produkteve bankare.

Është shënuar rritje në transaksione bankare dhe në vazhdimësi po punohet në përmirësimin e platformave elektronike. Projekti i degëve me shërbime pa para të gatshme, me degën e parë që tashmë ka muaj që po operon si e tillë, na bën më entuziast për eksplorimin e inovacioneve të reja teknologjike që të krijojmë për klientët tanë përvoja të reja, dhe për të mbetur banka e rekomanduar për klientët tanë.

Këtë vit, BPB ka festuar dy dekada të operimit andaj në emër të Bordit të Drejtorëve shpreh mirënjohjen tonë për rezultatet dhe progresin e arritur.

Gjatë kohës së shkrimit të kësaj letre, sfida të reja globale kanë shpërthyer për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Zinxhirët global të furnizimit të ndërprerë nga pandemia po përjetojnë një tjetër goditje të rëndë. Tregtia globale, çmimet e energjisë dhe të mallrave të tjera do të përjetojnë një luhatshmëri të paparë në dekada. Kjo do të ketë një ndikim të madh edhe Kosovë poashtu. Strategjia e BPB-së, me fokus tek SME-të dhe klientët individual, së bashku me diversifikimin e gjerë në industri të ndryshme, është gati për t'u përballur me këto sfida të reja.

Falënderoj klientët tanë që qëndruan me ne gjatë këtyre kohërave pandemike, aksionarët për mbështetjen e tyre, menaxhmentin ekzekutiv për udhëheqjen dhe të gjithë kolegët për përkushtimin dhe angazhimin e tyre, duke mbetur entuziast për planet afatgjate që e presin bankën.

Në emër të Bordit të Drejtorëve,

Ansis Grasmanis

Kryetar i Bordit të Drejtorëve



LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Arton Celina
KRYESHEF EKZEKUTIV

Të nderuar lexues,

20 vjetori i Bankës për Biznes e ka gjetur institucionin tonë me performancën më të mirë financiare që nga fillimi i operimit. Pavarësisht vërshtirësive të përgjithshme për shkak të pandemisë, në BPB ka pasur vazhdimësi të angazhimeve dhe projekteve për të avancuar proceset dhe shërbimet tona për klientët në vend.

Rritja e vazhdueshme e bankës ka bërë që BPB-ja të zgjerohet në 26 degë në tërë Kosovën, me gati 400 punonjës, duke u shërbyer kështu më shumë se njëqind mijë klientëve që po rriten dita ditës. Ripozicionimi i BPB-së, si partner kryesor i bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe për ekonomitë familjare, ka zgjeruar mundësinë për qasje në financa për ekonominë e vendit tonë përmes Bankës tonë, duke rritur kështu edhe portofolin e kredisë dhe të depozitave.

Modeli jonë i biznesit bazohet në zhvillimin e klientëve në aspektin e shërbimeve financiare dhe jo-financiare. BPB ka treguar se synon të jetë banka e zgjedhur për klientët tanë të synuar. Strategjia e BPB-së doli të ishte e duhura. BPB tashmë ofron një ekosistem biznesi për industrinë bankare që i mundëson bankës dhe klientëve të guxojnë dhe të kërkojnë më shumë nga partnerët e tyre bankar dhe të biznesit.

Vetëm në vitin e fundit, BPB ka organizuar Akademitë e Biznesit në rajonet kryesore të Kosovës ku mbi 250 biznese kanë përfituar njohuri të fushës së menaxhimit të biznesit nga ekspertë të huaj të fushës dhe nga Kosova. Akademitë e Biznesit do të vazhdojnë të organizohen edhe gjatë këtij viti, duke u siguruar që shtrirja e atyre që kanë interesim dhe marrin njohuritë që kërkojnë nga programet e BPB-së të shkon vetëm duke u zgjeruar edhe në qytete tjera.

Është themeluar gjithashtu edhe sektori për klientët mikrofinanciar duke përgatitur fillimisht infrastrukturën e nevojshme dhe ofrimin e shërbimeve financiare dhe jo-financiare për këtë kategori të klientëve.

Ne jemi të vendosur që vazhdimisht të përmirësojmë kualitetin e shërbimeve për klientë dhe të rrisim kompetencat dhe njohuritë e punonjësve tanë. Këtë vit, BPB bëhet institucioni i vetëm bankar me Akademi të Burimeve Njerëzore, projekt për të cilin jam më së shumti entuziast dhe që do të ndihmojë bankën në trajnimin dhe edukimin e stafit të ri dhe ekzistues.

Rritja e BPB-së krahas performancës financiare i mundëson institucionit tonë që të jetë në koherencë me investimet drejt dixhitalizimit, transformim ky që është duke shkuar me hapa më të shpejtë për shkak të pandemisë dhe nevojës për t'iu përshtatur klientëve me inovacionet e fundit.

BPB vazhdon të mbetet e përkushtuar për të ruajtur rolin e saj në sektorin bankar vendor, duke mbajtur një pozicion kyç, specifikisht duke ditur edhe nevojën për të luajtur rolin tonë ndaj shoqërisë. Banka e vendit për këtë arsye angazhohet në vazhdimësi që të ketë rolin e qytetarit aktiv përmes mbështetjes së projekteve që kanë ndikim direkt në rritjen e ndërgjegjësimit për tema të rëndësishme. Sigurisht, për vitin e ardhshëm planifikohet zgjerim i ofertave e shërbimeve jo vetëm atyre bankare.

Stafin dhe të gjithë udhëheqësit i falënderoj për punën e mirë dhe të palodhshme, duke qenë i bindur se sukseset e përbashkëta do të jenë vetëm vazhdimësi e punës së bërë deri më tani.


Falënderoj aksionarët dhe Bordin e Bankës për besimin në këtë institucion ndërsa klientët që na qëndruan pranë gjatë gjithë kësaj kohe.


Në emër të BPB,

Arton Celina

Kryeshef Ekzekutiv

STRUKTURA ORGANIZATIVE





ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE INDUSTRIA BANKARE

Pas një viti relativisht sfidues për ekonominë e vendit në vitin 2020, që u karakterizua me masa kufizuese të lëvizjes dhe operimit për shkak të pandemisë Covid-19, viti 2021 solli një pikë kthese në aspektin ekonomik dhe shoqëror për shkak të heqjes së atyre masave, kampanjave të vaksinimit të popullatës, dhe një përshpejtimi ekonomik, sidomos nga tremujori i dytë e tutje.

Në vitin 2021, rritja ekonomike iu kthye trendeve pozitive dhe u përmbyll me një rritje vjetore afër 10%. Rritje të konsiderueshme shënuan sektorët e akomodimit dhe ushqimit, transportit, agrikulturës etj. Eksportet shënuan rritje dhe atë kryesisht në eksportin e shërbimeve të udhëtimit dhe transportit. Ndërkohë që që bilanci negativ tregtar i mallrave vazhdon të thellohet.

Përveç lirimit të masave kufizuese, ndër ndikimet kryesore në këtë përshpejtim të rritjes ekonomike gjatë vitit ishin edhe numri i madh i vizitorëve nga diaspora për dallim nga viti paraprak si dhe masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike. Ekonomia e vendit vazhdon të mbetet e varur në masë të madhe nga dërgesat të cilat në vitin 2021 arritën vlerën prej mbi 1.1 miliardë euro. Bashkë me rritjen ekonomike, ndër elementet që vlen për t'u theksuar ishin edhe niveli me i lartë i inflacionit ndër vitet e fundit, me një mesatare vjetore prej 3.4%, i shtyrë nga rritja e çmimit të transportit, energjisë dhe materialeve të ndërtimtarisë.

Sikurse ekonomia në nivel të përgjithshëm, edhe industria bankare kishte një performancë të mirë në vitin 2021. Në këtë vit ishin gjithsej 11 banka që operuan në vend, me 199 njësi të shpërndara në territorin e Kosovës. Numri i të punësuarve në industrinë bankare në fund të vitit ishte rreth 3,500.



Vlera e asetëve të bankave në Kosovë arriti në 5,960 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11%. Ekspozimet kreditore, që paraqesin pozicionin kryesor të bilancit të asetëve të bankave në Kosovë, kishin një rritje prej 15.5%, duke arritur vlerën prej 3.7 miliardë euro në fund të vitit. Pjesa më e madhe e ekspozimeve kreditore vijon të jetë ndaj bizneseve dhe institucioneve tjera jo-financiare që përbëjnë rreth 62% të portofolit të përgjithshëm kreditor të bankave, ndërsa pjesa tjetër u takon ekspozimeve kreditore për ekonomitë familjare. Kualiteti i portofolit i matur përmes parametrave të kredive jo-performuese mbetet në nivel të kënaqshëm, duke u përmirësuar edhe më tutje në vitin 2021 në vlerën prej 2.3%, e që është i mbuluar me provizione në masën mbi 150%.

Depozitat në banka po ashtu kishin një rritje përgjatë vitit me 12.4% dhe arritën vlerën prej 4.9 miliardë euro. Pjesa më e madhe e depozitave janë nga ekonomitë familjare dhe struktura e depozitave në vend dominohet kryesisht nga depozitat e transferueshme të mbajtura në llogari rrjedhëse të cilat përbëjnë mbi 67% të të gjitha depozitave. Industria vazhdon të ketë një raport të mirë prej 76% mes kredive dhe depozitave.

Mesatarja e normave të interesit (për kreditë e reja) pësoi një ulje prej 0.2pp, nga 6.0% në 5.8% në fund të vitit, duke ndjekur një trend të njëjtë rënës të viteve të fundit. Norma mesatare e depozitave të reja gjithashtu pësoi një rënie të lehtë duke arritur në 1.3%, në krahasim me 1.5% sa ishte në vitin paraprak. Të hyrat nga interesi u rritën me rreth 6.9%, duke arritur vlerën prej 227 milionë euro, ndërsa shpenzimet e interesit pësuan një rritje të lehtë prej 3.5 milionë euro, duke arritur vlerën prej 24.4 milionë euro. Profiti i përgjithshëm i industrisë bankare shënoi një rekord prej 117 milionë euro, duke pasur një rritje nga viti 2020 me rreth 47%, dhe duke prodhuar një kthim mesatar në kapital prej 19.5%.




PERFORMANCA FINANCIARE E BANKËS

Viti 2021 shënoi një rritje të kërkesës në shumë sektorë ekonomikë, e cila nxiti drejtpërdrejt kërkesën edhe për shërbime bankare. Banka gjatë vitit shënoi rritje pozitive duke ndjekur trendet e tregut dhe të ekonomisë dhe mund ta shikojmë vitin 2021 si një vit i arritjeve me një performancë të suksesshme financiare.

Kjo performancë e mirë financiare ia ka mundësuar dhe do t'ia mundësojë Bankës sonë që edhe në të ardhmen të ketë një qëndrueshmëri shumë të mirë financiare, të ndërmarrë investime të nevojshme në modernizimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe t'i avancojë edhe më tutje proceset e brendshme për t'i përmbushur nevojat e klientëve tanë dhe të jetë e përgatitur të përballet me sfida të reja.


Banka ka një bilanc të qëndrueshëm të gjendjes, pozicion të fortë kapitali dhe likuiditeti dhe nivel të kënaqshëm të kredive jo-performuese. Në fund të vitit 2021, Banka mbylli vitin me total asete prej 379 milionë euro, ose 13.2% rritje krahasuar me vitin 2020.

ASETET




Struktura e aseteve të Bankës për Biznes vazhdoi të dominohej nga kreditë dhe paradhëniet për klientët, duke arritur në 61.3% të total aseteve të Bankës. Kreditë bruto arritën në totalin prej 240 milionë euro në fund të vitit, duke pasqyruar një rritje prej 19.8% krahasuar me vitin paraprak. Banka vazhdon të mirëmbajë një portofol të qëndrueshëm kreditor me 2.45% të kredive jo-performuese, nga 2.68% sa ishte në vitin 2020.

KREDITË BRUTO




DEPOZITAT



Depozitat e klientëve vazhduan me trend rritës dhe përbënin 85% të total aseteve të Bankës. Depozitat totale të klientëve arritën në 322 milionë euro në vitin 2021, duke shënuar një rritje prej 11.5% në krahasim me një vit më herët.

FITIMI NETO



Të ardhurat neto nga interesi për vitin 2021 ishin 15.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 14.6%, ndërsa të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet ishin 2.2 milionë euro, një rritje prej 20.5% krahasuar me vitin paraprak. Banka ka arritur të mirëmbajë një marzhë të synuar të të hyrave nga interesi, duke mirëmbajtur një kosto të ulët të financimit. Shpenzimet operative për vitin 2021 ishin 9.2 milionë euro. Rritja në total shpenzimet operative konsiston me rritjen e shpenzimeve të përgjithshme si vazhdimësi e aktivitetit të biznesit dhe investimeve në zhvillimin profesional të stafit.

Sa i përket treguesve të përfitueshmërisë, në fund të vitit 2021 Banka arriti fitimin neto prej 7.9 milionë euro, që është fitimi më i lartë në historinë e Bankës. Kthimi në ekuitet në fund të vitit 2021 ishte 20.2%, krahasuar me 13.73% sa ishte në vitin 2020. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit ishte 18.15%, mjaftueshëm mbi limitet e parapara rregullative.

Performanca financiare e vitit 2021 e cila rezultoi me rritje pozitive në të gjithë parametrat kryesorë financiarë të Bankës do të mundësojë që Banka në vitin 2022 të ndjekë edhe më tutje këtë rritje duke rritur portofolin kreditor dhe shërbimet bankare, si dhe duke zgjeruar linjat e saj të biznesit me shërbime inovative.



ZHVILLIMET NË BIZNES

KLIENTËT E BIZNESIT

Fokusi kryesor i BPB-së mbetet ofrimi i shërbimeve cilësore financiare dhe jo-financiare për klientët e biznesit në vend. Duke marrë parasysh faktin se ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MNVM) përbëjnë shumicën e bizneseve që operojnë në Kosovë dhe kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik duke krijuar vende pune, BPB vazhdon të fokusohet në mënyrë të veçantë në zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve mikro duke ofruar një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare.

BPB ka treguar vendosmërinë për të qenë banka lidere në treg për klientët e biznesit mikro, andaj gjatë vitit 2021, banka ka disbursuar mbi 34 milionë euro kredi për 1,700 klientë të biznesit mikro, nga të cilët 42% ishin klientë të rinj. Krahasuar me vitin 2020, sektori i bizneseve mikro të BPB-së është rritur me 18% me një portofol të kredive mirë të diversifikuar dhe me cilësi të lartë. Banka ka vijuar me përmirësimin dhe përditësimin e kanaleve elektronike, ku numri i klientëve të biznesit mikro që i përdorin këto platforma është rritur me 30%. Për më tepër, 80% e transfertave dalëse kombëtare janë kanalizuar përmes platformave tona elektronike me çmime më të favorshme.

Për sa i përket NVM-ve, me një portofol kredish prej 34.4 milionë eurosh të fokusuar kryesisht në sektorët e prodhimit dhe tregtisë, banka ka vënë në jetë strategjinë e zgjerimit me qëllim të financimit të këtij segmenti. Përveç qasjes në financa, mbështetja e bankës për bizneset shtrihet në shërbimet e këshillimit, me theks në avancimin dhe zgjerimin e kapaciteteve në aspekte shumëdimensionale duke filluar nga planifikimi strategjik, strategjia e rritjes dhe qeverisja e korporatave.

Shërbimet e këshillimit kanë qenë një program i veçantë i ofruar për klientët e NVM-ve, i cili u mundësua përmes partneritetit strategjik me “European Fund for Southeastern Europe (EFSE)”, e që rezultojë në organizimin e përbashkët të Akademive të Biznesit. Ngjarjet e tilla si kjo kontribuan në avancimin e edukimit të bizneseve, të ofruara në një formë unike përmes shërbimeve jo-financiare me synim rritjen dhe zhvillimin e proceseve të biznesit si dhe të vetë pronarëve të bizneseve. Rëndësia e rritjes së nivelit të edukimit të NVM-ve do të vazhdojë të jetë objektiv i bankës. Në vitin 2021, në bashkëpunim me konsulentë të jashtëm, banka ka trajnuar mbi 250 biznese në 7 rajone kryesore të Kosovës. Në vend të dhënies së leksioneve, objektiv i bankës është t'u ofrojë pronarëve të bizneseve instrumente specifike me qëllim të vetëvlerësimit të pozicionit aktual dhe të ardhshëm të operacioneve dhe orientimit të tyre të biznesit. Ne vërtet besojmë se BPB ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme dhe ka avancuar njohuritë e përgjithshme në menaxhimin strategjik të biznesit, menaxhimin financiar, planifikimin, rritjen e qëndrueshme të biznesit dhe tema të tjera të rëndësishme. Nga ana tjetër, banka zbaton një strategji të veçantë në sektorin e agrobiznesit duke ofruar shërbime bazuar në nevojat specifike të agrobiznesit. Kjo bëhet duke mbajtur një kontroll të mirë cilësinë e portofolit duke marrë parasysh brishtësinë e këtij segmenti specifik.

Po ashtu, BPB është e vetëdijshme se përfshirja financiare vazhdon të jetë sfida në tregun vendor. Si rezultat, banka ka ndërmarrë një strategji të qartë në këtë drejtim duke krijuar sektorin mikrofinanciar brenda bankës. Ky sektor po adreson një numër çështjesh për klientë të cilët aktualisht nuk janë të shërbyer nga bankat, përfshirë profesionistë individual përveç tjerëve.

Logjika prapa kësaj linje biznesi pritet të luajë një rol të rëndësishëm duke hapur rrugën e zhvillimit për një profili të tillë klienti. Si përfundim, me sektorin e mikrofinancës, banka është e sigurt se ka krijuar një ekosistem të biznesit të qartë dhe të fokusuar nga mikrobiznesi tek SME-të duke zbatuar parimin e gradimit.

Trendet pozitive janë ndihmuar në disa aspekte nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike e miratuar nga Qeveria e Kosovës si përgjigje ndaj ndikimit të pandemisë në biznese. Kjo pako mundësoi dhe siguroi likuiditet financiar përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) që mundësoi qasjen në financa përmes kërkesave më të lehta për kolateral dhe programe për ndarjen e rrezikut. Përmes këtij fondi, banka rriti kreditimin dhe ndihmoi bizneset të zgjerojnë më tej kapacitetet e tyre gjatë një periudhë kohore shumë delikate, duke siguruar qasje në financa prej 14 milionë euro, përfshirë disa projekte të kompanive të reja (startup).

Duke marr parasysh të gjitha këto elemente, BPB si një institucion financiar agjil, ka vazhduar dhe nënshkruar një marrëveshje me BERZH-in për një fondi prej 5 milionë euro, i cili do të përdoret për financimin e klientëve tanë për vitin e ardhshëm (2022) me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe pranisë së tyre duke përmbushur standardet dhe kërkesat më të fundit të BE-së. Fondi do të jetë i disponueshëm për klientët e rinj dhe ekzistues të cilët do të investojnë në ngritjen e kapaciteteve të bizneseve të tyre në përputhje me kriteret e programit, duke pasur parasysh kushtet ndërkombëtare të të bërit biznes. Si paketë, programi ka edhe komponentin e incentivës, duke ofruar grant prej 15% të investimit total të bërë nga klienti.

Banka do të vazhdojë të prezantojë edhe më tej shërbime inovative bankare. Infrastruktura e nevojshme për shërbimet Faktoringut për klientët e biznesit tashmë është projektuar dhe testuar. Në fillim të vitit 2022, banka planifikon të lansojë produktin i cili do të mundësojë shlyerjen e faturave në mënyrë shumë më të lehtë me kushte të favorshme për sa i përket kohës dhe çmimit. Avantazhi më i madh konkurrues është se shërbimi i Faktoringut do të ofrohet si për financimin e blerjeve ashtu edhe për zinxhirin e furnizimit.



KLIENTËT INDIVIDUALË

BPB vazhdoi zhvillimin në mënyrë të konsiderueshme në portofolin e klientëve individual përmes një rritjeje të kontrolluar, duke i qëndruar besnike profilit specifik të klientit të saj, veçanërisht pagë marrësve buxhetorë. Banka ka disbursuar mbi 64 milionë euro për klientët individual gjatë vitit të kaluar që ka rezultuar në rritje prej 24 milionë euro të portofolit të kredive, ndërsa ka arritur një total portofol të kredive prej 111 milionë euro. Numri total i klientëve kreditor ka arritur në 12,200 nga të cilët 1,100 ishin klientë të rinj që janë pagëmarrës buxhetorë, duke konfirmuar kështu që sektori i klientëve individual mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të bankës për sa i përket performancës dhe cilësisë së portofolit.

Pozicionimi i BPB-së si një bankë e përkushtuar ndaj kujdesit ndaj klientit ka ndikuar në zgjerimin e mëtejshëm të Bankës, duke reflektuar stabilitetin dhe besueshmërinë e klientëve ndaj Bankës. Si rezultat, kjo ka çuar në rritje të dukshme në depozita të qëndrueshme dhe të diversifikuara. Portofoli në anën e depozitave ka tejkaluar shumën totale prej 320 milionë euro, nga të cilat shumica absolute i takon klientëve individualë.

Për më tepër, BPB ka vazhduar të përparojë dhe të ofrojë modalitete të ndryshme të shërbimeve bankare të përcaktuara në modelin e saj të biznesit. Duke qenë e përkushtuar ndaj kësaj kategorie të klientëve, Banka ka dizajnuar oferta përmes kampanjave të ndryshme të fokusuara në plotësimin e nevojave të klientëve tanë ekzistues dhe të rinj potencial. Këto oferta, përveçse kanë sjellë rezultate të padiskutueshme, kanë lehtësuar dhe përmirësuar edhe cilësinë e jetës të shumë klientëve tanë duke ofruar këshilla për rinovimin e shtëpisë dhe efikasitet të energjisë.



Duke marrë parasysh kërkesat dhe mundësitë e klientëve në treg, BPB ka dizajnuar produktet e veta kreditore specifike duke ofruar lehtësime të kontrolluara në mbulueshmërinë e kredive me hipotekë, maturitete më afatgjata për investime familjare afatgjata, lehtësime në kredi deri 15,000€ pa bashkëhuamarrës, si dhe mundësi të hapjes së llogarive për të gjithë pagëmarrësit duke ua ofruar një vit mirëmbajtjen falas.

Përveç ofertave, Banka ka zgjeruar edhe gamën e shërbimeve jo-financiare gjatë vitit 2021 duke mundësuar për të gjithë klientët individualë edhe shërbimin “Sigurimi i Jetës së Kredimarrësit” në katër pako të ndryshme të cilat mundësojnë veçori të ndryshme në pakon e sigurimit. Për më tepër, me qëllim të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të klientëve dhe në linjë me strategjinë e Bankës, banka ka implementuar degën pa kesh, duke ofruar të gjitha shërbimet bankare pa kesh për klientë në zonën 24/7. Në këto zona, klientët do të kenë qasje të pandërprerë për përmbushjen e nevojave të bankare, siç janë deponimet dhe tërheqjet e parave, transferet e parave dhe të gjitha shërbimet tjera të cilat ofrohen nga bankomatet më moderne. Nga ky investim, klientët do të kursejnë kohën e tyre duke u shërbyer pa kufizim të orarit të punës.

Ky koncept ka filluar së implementuari dhe do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme për t’u zgjeruar në degët tjera. BPB mbetet e përkushtuar të vazhdojë fuqishëm në avancimin e mëtutjeshëm, duke mbajtur gjithmonë në qendër të vëmendjes klientët tanë. Si rrjedhojë, banka do të vazhdojë angazhimin e saj në avancim e mëtejme, duke i mbajtur klientët gjithmonë në qendër të vëmendjes.



**SIGURIMI I JETËS
PËR KREDIMARRËS**

KUJDESI NDAJ KLIENTIT

Viti 2021 ka qenë një vit jo vetëm i orientuar në plotësimin e kërkesave të klientëve, përmbushjen e nevojave të tyre gjatë gjithë kohës nga krijimin e marrëdhënies dhe tutje, por dhe i fokusuar në mirëmbajtjen dhe rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së klientëve tanë krahas shërbimeve që ata marrin. Në mënyrë që të jetë sa më afër klientëve të saj, BPB e ka lehëtuar qasjen e klientëve në bankë përmes përdorimit të platformave të ndryshme si dhe atyre online për aplikim të shërbimeve, qendrës së thirrjeve 24/7 dhe kanaleve të tjera të komunikimit. Përmes formave të ndryshme, Banka vazhdon të matë rregullisht përvojën e klientëve më shërbimet e bankës si dhe përvojën e tyre gjatë përdorimit të kanaleve dhe platformave tona të ndryshme.

Suksesi dhe orientimi ndaj klientit tregohen edhe me rezultatet e hulumtimit të pavarur të matjes së kënaqshmërisë së klientëve (NPS). Ky indikator ka treguar se përgjatë vitit 2021, BPB ka arritur ta mbajë njëjtë këtë indikator në vlera shumë të kënaqshme, me rezultatin me të lartë të NPS në treg, gjë që tregon se BPB është një nga bankat me klientët më besnikë.



Për të rritur edhe më tej fokusin, Banka ka themeluar edhe një departament të veçantë me infrastrukturë përcjellëse në kuadër të linjës së biznesit të përkushtuar ndaj kujdesit ndaj klientit. Automatizimi i disa proceseve në kuadër të procesit të trajtimit të ankesave dhe investimi në platforma të reja si ajo e CRM i kanë shtuar vlerë menaxhimit me klientë. Implementimi i platformës së re të CRM-së për qendrën e thirrjeve ka mundësuar për herë të parë që të kemi një histori të ndërveprimit me klientë, profil të krijuar për secilin klient që shërbehet te qendra e thirrjeve, rezultate në kohe reale etj.

Po ashtu, për të ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj klientit, është krijuar edhe sistemi i përgjigjes së shpejtë për degë i njohur si 'QR Code Vlerësimi' e që mundëson mbledhjen e opinioneve nga klientët për të përmirësuar edhe më tutje shërbimet dhe proceset në Bankë.



ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Investimet në zhvillimin e produkteve të ndikuara nga avancimet e teknologjisë në nivel global kanë vazhduar të jenë në fokus të Bankës edhe gjatë vitit që lamë pas, në mënyrë që shërbimet e ofruara të jenë konkurrense, cilësore dhe t'i përmbushin nevojat e klientëve.

Si rrjedhojë, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të punës dhe gjithmonë me fokus tek klientët, Banka ka vazhduar të punojë në diversifikimin e kanaleve shërbyese që do t'u mundësojnë klientëve përmbushje të nevojave të tyre. Transformimi i shërbimeve në kanale digjitale u nxit edhe me tepër nga rrethanat e krijuara si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe lëvizjes së kufizuar, me ç'rast Banka u siguroi t'i mobilizojë punonjësit duke u orientuar kah modeli i punës në distancë, model ky që rezultoi të jetë motivues, atraktiv për punëtorët dhe nuk rrezikoi kualitetin e shërbimit ndaj klientëve.

Në linjë me këtë strategji, Banka është angazhuar në mbështetjen e biznesit në zhvillimin e produkteve të reja. Njëkohësisht, është punuar në ngritjen e kualitetit të shërbimeve, për t'ua mundësuar klientëve që në mënyrë të pavarur dhe të lehtë t'i realizojnë transaksionet e tyre 24/7. Duke u nisur nga fakti se platformat e bankimit elektronik sot janë pjesë përbërëse e përditshmërisë për menaxhimin e financave të secilit individ, Banka është përkujdesur të implementojë mekanizma që mundësojnë monitorimin e performancës në kohë reale për të siguruar disponueshmëri të lartë.

Për të mbështetur edhe më tej synimin drejt ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme, janë thelluar investimet në qendrën e rimëkëmbjes në rast fatkeqësive të cilat garantojnë vazhdimësinë e biznesit në degë dhe operimin e kanaleve alternative pa ndërprerje.

Thellimi i investimeve në zgjerim të produkteve, kualitet të shërbimeve ekzistuese dhe infrastrukturë ka prodhuar rezultate të shkëlqyeshme në përdorshmërinë e kanaleve elektronike, respektivisht në rritjen e numrit të përdorueseve të platformave elektronike, kartelëmbajtëseve si dhe numrin e transaksioneve. Krahas kësaj rritjeje, është punuar në ngritje të sigurisë së shërbimeve digjitale përmes mekanizmave shtesë që mundësojnë monitorimin e transaksioneve.

Pavarësisht rrugës së transformimit digjital, dega dhe stafi në degë do të mbeten akterët kryesorë dhe më të rëndësishmit, drejt përmbushjes së objektivave të Bankës. Kjo pasi përmes stafit të degëve krijohen, thellohen dhe mirëmbahen relacionet me klientë, e që rezultojnë të jetë çelësi i suksesit të çdo institucioni. Nëse gjerë më dje ka qenë e mjaftueshme vetëm përmbushja e nevojave të klientëve, sot Banka është e interesuar jo vetëm të ofrojë shërbime por ato të jenë mbresëlënëse dhe joshëse për klientët.


Shpejtë, Lehtë, Sigurtë



BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMET

Në Bankën për Biznes, ne e dimë se njerëzit tanë qëndrojnë në themel të institucionit dhe drejtojnë suksesin tonë të vazhdueshëm. Kjo është arsyeja pse ne përpiqemi të rekrutojmë, zhvillojmë dhe mbajmë punonjës shumë të talentuar në të gjitha fushat e institucionit tonë dhe të ofrojmë një vend pune gjithëpërfshirës dhe inovativ ku të gjithë mund të zhvillohen dhe të prosperojnë.

Kapitali jonë njerëzor në një shikim



Kultura organizative është baza e suksesit tonë

Kultura organizative është një komponent thelbësor i institucionit tonë që rezulton me një ndikim të rëndësishëm në performancën individuale, por edhe performancën organizative. Banka për Biznes synon që secilit nga të punësuarve t'i ofrojë një ambient të përshtatshëm punësimi, duke i ofruar një gamë të gjerë mundësish për avancim.

Punonjësit janë në thelb të kulturës sonë organizative dhe ne kërkojmë kontributin e tyre për të na ndihmuar të përmirësohemi. Sondazhet në mënyrë të rregullt mbledhin reagime të punonjësve për angazhimin, aftësimin, mjedisin e punës, efektivitetin e përgjegjësit të linjës dhe pritshmëritë e tyre. Në bashkëpunim me kompani të jashtme, sondazhi ynë i punonjësve anketon në mënyrë anonime të gjithë punonjësit e Bankës, duke matur pikëpamjet në disa dimensione. Rezultati mesatar për vitin 2021 i Employee Net Promoter Score (eNPS) është 22.1, indeks i cili tregon gatishmërinë e punonjësve të Bankës sonë për ta rekomanduar BPB-në si një vend të mirë për të punuar. Përgjigjet e sondazhit tregojnë se punonjësit tanë ndihen të përfshirë dhe krenarë për të punuar në BPB. Përmes këtij pyetësi inkurajojmë punonjësit të paraqesin ide për përmirësim dhe të bashkëpunojnë për zgjidhje në mënyrë që edhe Banka të adresojë çështjet me rëndësi për ta dhe institucionin.

Për më shumë, ne jemi të bindur se udhëheqësit luajnë një rol kyç, pasi që të udhëhequrit drejtojnë kulturën dhe kjo e fundit drejton performancën. Kështu, pikëpamja jonë mbi udhëheqjen përshkruan sjelljen ndaj punonjësve, klientëve dhe aktiviteteve të biznesit që pritet nga çdo drejtues në BPB. Në trajnimet e përgjegjësve të linjës përfshihen konceptet kryesore sikurse janë programet e zhvillimit të lidershit, trajnimi i stafit, proceset e rekrutimit etj.

Angazhimi ynë për të zhvilluar të punësuarit dhe për trajtim të drejtë për të gjithë

Në një mjedis dinamik si i yni, kapitali njerëzor i larmishëm është avantazh konkurrues. Strategjia jonë është të vazhdojmë të formojmë këtë institucion të larmishëm dhe gjithëpërfshirës që është inovativ, ofron shërbim të jashtëzakonshëm për klientët tanë, përmban mundësi të barabarta për secilin dhe është një vend i mrekullueshëm për të punuar për të gjithë.

Si pjesë e integruar e strategjisë sonë për të punësuarit është rekrutimi i kandidatëve potencialë dhe përshtatja kulturore duke përdorur teknologji inovative dhe duke vlerësuar përvojën e personit, kompetencat, aftësitë e të mësuarit dhe aftësitë analitike. Ne kemi rekrutuar 95 punonjës dhe 31 praktikantë në vitin 2021, si dhe kemi promovuar 40 anëtarë stafi. Promovimi dhe lëvizja në pozita brenda Bankës ndikon në angazhim më të madh të punonjësve, bashkëpunim të zgjeruar, rritje të produktivitetit dhe përfitim për punonjësit, Bankën dhe klientët tanë. BPB në fillim të vitit ka lansuar platformën e punësimit duke ua mundësuar kandidatëve potencialë dhe punonjësve të Bankës t'i eksplorojnë shtigjet e karrierës në role që përputhen me interesat e tyre brenda institucionit.

Programi “BPB Junior” i lansuar në vitin 2018 vazhdon të rrisë trajnimin dhe rekrutimin të rinjve para diplomimit apo të sapodiplomuarve në BPB. Ky program është tranzicioni më i mirë i mundshëm për studentë në fillimin e karrierës së tyre në Bankë. Në vitin 2021, ky program ka zhvilluar dhe transformuar 21 juniors, prej të cilëve 16 studentëve iu është dhënë mundësia e fillimit të karrierës në Bankën tonë në funksione kritike.

Trajnimi dhe zhvillimi brenda BPB-së luan një rol kryesor në ndërtimin e aftësive dhe shkathtësive për të ardhmen. Në fillim të vitit 2021, ne nisëm programin e zhvillimit të punësuarve në degë të titulluar “Senior Program”, duke kaluar në disa faza vlerësimi, module trajnimi dhe përfshirje në projekte specifike, për të diplomuar dhe ndihmuar në promovim profesional brenda institucionit tonë.

Ne synojmë t'i harmonizojmë interesat e punonjësve tanë me interesat tona, dhe pasqyrojmë këtë qasje në filozofinë dhe programet e zhvillimit. Lansuar gjatë vitit 2021, përmes “Successor Program” është ofruar trajnim me katër module të ndryshme të udhëheqjes nga trajnerë ndërkombëtarë. Në përgjithësi, punonjësit tanë përfunduan mbi 100 aktivitete trajnuese dhe mësimore gjatë gjithë vitit.

E ardhmja e punës, dhe përgatitja e të punësuarve brenda BPB-së për të ardhmen

Ne besojmë se e ardhmja e punës do të kërkojë kapital njerëzor dhe punë ekipore për t'iu përgjigjur rrethanave gjithnjë në ndryshim, si dhe sjelljes dhe kërkesave të klientëve në zhvillim. Duke u mbështetur në përvojën dhe aftësitë tona, ne përqafojmë transformimin kulturor dhe digjital për t'ua mundësuar punonjësve tanë të kenë sukses në mjedise të reja dhe të mbetemi një punëdhënës i zgjedhur.

BPB është e përkushtuar për themelimin e një Akademie për zhvillimin e të punësuarve. Qëllimi kryesor i Akademisë do të jetë përhapja e strategjisë së Bankës tek të gjithë punonjësit, në mënyrë që të gjithë të ndihen pjesë dhe të angazhuar me vizionin e saj, dhe të mund të kontribuojnë çdo ditë në qëllimet strategjike afatgjate. Për më tepër, do të sigurohen programe të vazhdueshme të zhvillimit të punonjësve. Duhet theksuar se BPB është e orientuar për promovimet e brendshme dhe Akademia do t'i ndihmojë punonjësit tanë t'i zhvillojnë këto aftësi edhe më tej. Ekipet të dedikuara në Bankë do të ndjekin dhe monitorojnë ciklin e zhvillimit të punonjësve dhe rrugën e tyre të karrierës hap pas hapi, duke trajnuar dhe ndërtuar aftësitë e tyre të nevojshme sipas rrugës së tyre të karrierës.

Të mësuarit në mënyrë elektronike, thënë ndryshe E-learning, do të jetë një metodë tjetër e mbajtjes së trajnimeve të shumta për punonjësit e Bankës sonë. Trajnimet online janë mbështetur theksueshëm gjatë situatës pandemike, duke rritur entuziazmin, fleksibilitetin dhe efikasitetin e stafit. BPB është zotuar të harmonizojë strategjinë e saj të biznesit për të qenë në përputhje me qëllimet e shoqërisë për të kontribuar në të. Me pak fjalë, BPB nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e një vendi pune, por ka të bëjë me ofrimin e karrierës dhe mundësive të zhvillimit.





APLIKO KËTU

BPB
junior



PROGRAMI
BPB JUNIOR

MENAXHIMI I RREZIKUT

Viti 2021 ishte një vit më i mirë për menaxhimin e rrezikut krahasuar me vitin 2020, duke konsideruar edhe situatën pandemike që po vazhdonte. Lehtësimet e masave (nga Covid-19) kanë ndihmuar sektorin bankar për rikuperimin nga humbjet e mundshme të vitit të kaluar.

Në aspektin e menaxhimit të likuiditetit, duke konsideruar edhe vazhdimësinë e Covid-19, Banka ka vazhduar me menaxhim efikas të likuiditetit duke ruajtur nivele të larta të likuiditetit gjatë gjithë vitit në mënyrë që të plotësohen nevojat dhe detyrimet e klientëve në çdo kohë. Gjithashtu, Banka ka mirëmbajtur dhe siguruar nivelin e duhur të aseteve likuide për të qenë në pajtueshmëri me kërkesat rregullative dhe limitet e brendshme, si dhe për të përballuar edhe situatat më stresuese dhe të pafavorshme.

Për menaxhimin e rrezikut operacional, gjatë vitit 2021 janë rishikuar dhe avancuar praktikat më të mira në mënyrë që çdo ekspozim ndaj këtij rreziku të jetë i kontrollueshëm dhe në nivel të pranueshëm. Duke konsideruar edhe sfidat kundrejt situatës pandemike, Banka, nëpërmjet funksionit të menaxhimit të rrezikut operacional, ka arritur stabilitet dhe eksperiencë në menaxhim të çfarëdo situate të panjohur që mund të shfaqet. Sektori i rrezikut operacional ka vazhduar t'i menaxhojë dhe përmirësojë proceset e vazhdueshme, me fokus kryesor në indikatorët kyç të rrezikut dhe ngjarjeve të papritura që mund të shfaqen në çdo moment.

Në aspektin e menaxhimit të rrezikut kreditor, gjatë vitit 2021 është vërejtur përmirësim për shkak të rritjes së ekonomisë në përgjithësi. Lehtësimi i masave pandemike ka ndikuar pozitivisht në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, produkteve industriale dhe tregtisë me pakicë. Kjo ka ndihmuar në menaxhim më të mirë të portofolit kreditor, e sidomos portofolin që ka qenë subjekt i moratoriumeve dhe ristrukturimeve. Pavarësisht efektit pozitiv në rikuperimin e ekonomisë, si arsye e situatës pandemike, klima ekonomike ka vazhduar me ndryshime të reja në ekonominë e vendit tonë, gjithashtu dhe në nivel global. Mbyllja totale gjatë vitit 2020 dhe rritja e vrullshme gjatë vitit 2021 ka ndikuar në mosbalanca ekonomike duke rritur masivisht krizën energjetike dhe inflacionin në nivel global. Kjo gjithashtu është reflektuar në vendin tonë me disa probleme lidhur me energjinë, por më e dukshme ka qenë rritja e çmimeve si shkak i inflacionit. Inflacioni pritet të vazhdojë dhe në vitet në vijim, për të cilën menaxhimi i rrezikut ka vendosur masat e duhura për monitorimin dhe ndikimin që mund të ketë në solvencën apo aftësinë e pagimit të huamarrësve.

Banka ka pasur një rritje më të madhe të kredive krahasuar me vitin 2020, ku fokusi kryesor ka qenë rritja dhe diversifikimi i mëtejshëm i portofolit kreditor në segmentet me rrezik të ulët kreditor, siç janë kreditë individuale, mikro dhe një rritje më e vogël në kreditë e NVM-ve, ku një pjesë e konsiderueshme e rritjes së kredive është bërë edhe përmes FKGGK, respektivisht dritares së re të Planit për Rimëkëmbje të Ekonomike. Kjo strategji e Bankës ka ndikuar edhe në përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit të portofolit kreditor, krahasuar me vitet e kaluara.

Niveli i mbulueshmërisë me provizione në vitin 2021 ka qenë i kënaqshëm, ku Banka, bazuar edhe në situatën pandemike, ka mbajtur një nivel konservatizmi sa i përket provizioneve e sidomos për produktet kreditore të cilat u janë nënshtruar kushteve të lehtësimit.

Menaxhimi i rrezikut brenda Bankës sigurohet edhe mbi pajtueshmërinë e kërkesave rregullative që ndërlidhen me vlerësimin kualitativ të portofolit kreditor. Bazuar në këtë, menaxhimi i rrezikut edhe gjatë vitit 2021 është siguruar për përdorimin e kriterëve kualitativë për të përcaktuar ndjeshmërinë e rrezikut kreditor të portofolit.

Për më tepër, gjatë vitit 2021, mbi menaxhimin më të mirë të ndjeshmërisë së rrezikut kreditor duke inkorporuar kështu edhe informacionet e ardhshme të faktorëve të cilët mund të kenë ndikim të mundshëm, janë përditësuar dhe implementuar edhe disa modele ku nëpërmjet tyre është arritur monitorim më i mirë i nivelit të provizioneve.

Duke filluar nga muaji dhjetor i vitit 2021, Banka ka zbatuar plotësisht përkufizimin e ri të dështimit bazuar në kërkesat e Autoritetit Evropian Bankar. Përcaktimi i ri i dështimit bazohet në pragje të materialitetit të detyrimeve të vonuara kreditore të huamarrësve. Gjithashtu, Banka ka implementuar modelin e përditësuar të faktorëve makroekonomikë, duke konsideruar kështu periudhën kohore bazuar dhe në situatën përkeqësuese si shkak i pandemisë.



PAJTUESHMËRIA

Banka është e përkushtuar që veprimtaria e saj të jetë në harmoni me ligjet, rregulloret, udhëzimet, standardet vendore dhe ato ndërkombëtare të qeverisjes së mirë korporative, me qëllim të rritjes së besueshmërisë së klientëve dhe rritjes së Bankës në baza të shëndosha.

Në Bankën tonë, pajtueshmëria konsiston në angazhimin e vazhdueshëm të respektimit të parimeve të integritetit, transparencës dhe profesionalizmit, si dhe në respektim të rregullave dhe parimeve të cilat janë thelbësore në mënyrën tonë të të bërit biznes dhe në ruajtjen e reputacionit të Bankës në treg.

Banka bën rishikimin e rregullt të dokumenteve të brendshme duke arritur nivel të lartë të harmonizimit të politikave dhe procedurave të brendshme me kërkesat ligjore dhe rregullative të vendit. Po ashtu, Banka në vazhdimësi ka bërë vlerësimin dhe monitorimin e implementimit të rregulloreve të Bankës Qëndrore të Kosovës, dhe si rezultat ka kontribuar në identifikimin e fushave të cilat kanë nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm në aspektin e pajtueshmërisë.

Banka ka identifikuar me kohë ndryshimet ligjore dhe rregullative që mund të ndikojnë në aktivitetet e Bankës, rrjedhimisht janë ndërmarrë hapat e nevojshëm, si në aspektin e informimit të palëve përgjegjëse brenda Bankës, ashtu edhe në aspektin e përditësimit të dokumenteve të brendshme dhe proceseve, me qëllim të harmonizimit të këtyre ndryshimeve me aktivitetet e Bankës.

Edhe në fushën e pajtueshmërisë për parandalim të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (AML-së), për Bankën vazhdon të jetë prioritet respektimi ligjor dhe rregullativ vendor, i direktivave dhe rregulloreve të BE-së, si dhe i praktikës më të mirë ndërkombëtare siç është përcaktuar nga “The Financial Action Task Force” (FATF). Banka ka bërë përmirësime të vazhdueshme në fushat kryesore në qasjen e bazuar në rrezik, detyrimet e kujdesit të duhur ndaj klientëve, bazën e të dhënave, analizimin dhe raportimin e aktiviteteve të dyshimta dhe trajnimin e punonjësve.

Banka aplikon politikë të veçantë të AML-së dhe ka strukturë adekuate për menaxhim të saj duke e pasur të përcaktuar zyrtarin përgjegjës të pavarur nga funksionet e tjera në Bankë. Gjithashtu, Banka e ka avancuar edhe më tutje sistemin dhe aplikacionin përkatës që mbështet monitorimin, analizimin dhe raportimin e aktiviteteve potencialisht të dyshimta bazuar në të dhënat të ndryshme dhe duke krijuar një pasqyrë të plotë të aktiviteteve brenda sistemit dhe klientëve të saj.

Trajnimi i stafit të Bankës në fushën e pajtueshmërisë ka qenë një ndër prioritetet tona, me ç'rast janë organizuar sesione trajnimi për të gjithë stafin, me qëllim të informimit dhe vetëdijësimit të tyre në lidhje me kërkesat ligjore dhe rregullative, aktiviteteve të pajtueshmërisë dhe kanaleve të komunikimit, duke theksuar në veçanti rolin e sinjalizuesit në Bankë.

Ndër objektivat kryesorë të Bankës në aspektin e pajtueshmërisë janë ofrimi sa më i madh i përkrahjes për funksionet e ndryshme të Bankës nga aspekti i interpretimit dhe zbatimit të kërkesave ligjore dhe rregullative, duke kontribuar në një mjedis sa më të shëndoshë i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e objektivave të Bankës dhe rritjen e saj në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme për Bankën. Edhe në të ardhmen, Banka është e përkushtuar që kërkesat ligjore e rregullative të respektohen në përpikëri, krahas vazhdimit të zbatimit të proceseve të përmendura më lart, do të punohet në kryerjen e aktiviteteve shtesë, të cilat kanë për qëllim theksimin e rëndësisë së pajtueshmërisë së aktiviteteve bankare me ligjet dhe rregulloret vendore.



SIGURIA E INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Në një kohë kur teknologjia informative është duke u zhvilluar me hapa shumë të shpejtë dhe klientët çdoherë e më tepër janë duke i shfrytëzuar shërbimet elektronike, BPB vazhdon t'i kushtojë rëndësi të veçantë sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave të klientëve.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2021 ne kemi vazhduar me investime në infrastrukturë dhe avancime të proceseve të ndryshme me qëllim të minimizimit të rrezikut në këtë fushë. Krahas aktiviteteve të rregullta, kontrolleve sistematike dhe atyre “ad-hoc”, janë ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin dhe menaxhimin e kërcënimeve të sigurisë kibernetike, vlerësimin dhe adresimin e dobësive, si dhe janë organizuar fushata dhe trajnime vetëdijesuese për punonjësit e Bankës në fushën e sigurisë së informacionit.

Banka synon që të krijojë kulturë të privatësisë duke respektuar në tërësi kuadrin ligjor ashtu siç është e përcaktuar në kuadrin ligjor e rregullativ për mbrojtjen e të dhënave personale. Mbrojtja e privatësisë së të dhënave zbatohet përmes një modeli qeverisës me role dhe përgjegjësi të përcaktuara, të definuara qartë në dokumente të brendshme, procese dhe në kontrolle të standardizuara.



Politika e mbrojtjes së të dhënave paraqet bazën për trajtimin e duhur të të dhënave personale lidhur me subjektin e të dhënave. Kjo politikë përfshin parimet e zbatueshme për të gjithë në lidhje me mbledhjen, përpunimin, përdorimin apo transferimin kombëtar dhe ndërkombëtar të të dhënave personale.

Për të përmbushur zotimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe për interesat e klientit në ruajtjen e privatësisë së të dhënave të tyre, Banka për Biznes ka caktuar zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale për t'i mbikëqyrur praktikën e privatësisë, për të ofruar ndihmë dhe rekomandime për të gjitha njësitë e Bankës dhe për të monitoruar respektimin e dispozitave ligjore në aspektin mbrojtjen e të dhënave.

Për të ngritur vetëdijësimin se mbrojtja e të dhënave është pjesë jetike e institucionit, duke përdorur ekspertizën dhe kompetencën adekuate në fushën e mbrojtjes së të dhënave, Banka zhvillon trajnime të rregullta për stafin mbi çështjet e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së tyre.

Për vitin 2022, krahas avancimit të vazhdueshëm të stafit, janë planifikuar investime në sisteme të ndryshme të Bankës, testime të rregullta të sistemeve, avancim të procesimit të inteligjencës për kërcënimet kibernetike, si dhe aktivitete tjera që kanë për qëllim monitorimin e vazhdueshëm të cënueshmërive të sigurisë dhe marrjen e masave për t'i mbrojtur sistemet e Bankës dhe klientët e saj.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Banka për Biznes është angazhuar edhe gjatë vitit 2021 duke kontribuar në komunitet përmes bashkëpunimeve që kanë ndikuar dukshëm në përmirësimin e kualitetit të ofrimit të shërbimeve të disa organizatave që tashmë janë partnerët tanë. Si bankë e vendit, për BPB-në në vazhdimësi është e rëndësishme që të tregojë se është derë kryesore për ata që synojnë të punojnë në të mirën e përbashkët për komunitetin, duke ofruar mundësi për angazhime të ndryshme në disa rrafshe.

Vitin 2021, BPB e ka nisur duke festuar dy dekada jetë me anë të kremtimit të kësaj date përmes promovimit të turizmit dhe kulturës vendore. Banka e vendit është bërë guidë nga kryeqyteti historik i shqiptarëve, Prizreni, duke sjellë përmes një videoje arsyet pse duhet të vizitohet ky qytet. Përveç Prizrenit, kjo guidë ka treguar edhe bukuritë e Rahovecit.

Organizatat që kanë në fokus gratë dhe fëmijët kanë qenë gjithashtu edhe këtë vit partnerët tanë kryesorë. BPB ka ndihmuar projektet me fokus mirëqenien sociale të organizatave Action for Mothers and Children, SOS Fshatrave dhe Down Syndrome Kosova.

Me DSK-në është nënshkruar partneriteti që garanton bashkëpunim 5-vjeçar, e që ka nisur nga projekti për të mundësuar që disa fëmijë që ishin në listë të pritjes për të marrë shërbime nga organizata, të financoheshin nga Banka.

Gjithashtu, është financuar trajnimi i organizuar nga ekspertët e BE-së, “Të ndërtojmë një shkollë gjithëpërfshirëse”. Tashmë synim kyç i BPB-së në partneritet me DSK-në është garantimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve terapeutike dhe sociale në këtë organizatë.



Zhvillimi i qëndrueshëm në shoqëri sigurisht se varet nga zhvillimi i sportit, andaj, në vitin 2021, BPB ka qenë partner kryesor i Federatës së Tenisit në Kosovë, sport ky shumë shpresëdhënës edhe për vendin tonë, e sidomos në vitet e fundit. BPB i ka qëndruar besnike edhe basketbollit vendor, derisa janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me KB Trepça dhe KB Ballkani.

Banka synon dhe sigurisht është në planet afatgjata që të vazhdojë përkrahjen për kategoritë e synuara me të cilat tashmë ekziston partneritet, megjithatë, do të jetë gjithmonë e angazhuar në projekte që shkojnë në të mirë të përgjithshme të shoqërisë, e për të cilat duhet vëmendje e veçantë.



PASQYRAT FINANCIARE

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORIT DHE PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2021

BANKA PËR BIZNES SH.A.

**Raporti i auditorit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin e
mbyllur me 31 dhjetor 2021**

PËRMBAJTJA**Faqe**

Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	3
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7- 97



Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e
Banka për Biznes Sh.a.

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Banka për Biznes Sh.a., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2021, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante në Kosovë për auditimin tonë të pasqyrave financiare dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Banka për Biznes Sh.a. më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar në raportin e tyre më 26 mars 2021.

Informata të tjera në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informata të tjera të prezentuara në Raportin Vjetor më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021. Informata të tjera përmbajnë informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor por nuk përfshijnë në to edhe pasqyrat financiare dhe Raportin e Auditorit të Pavarur.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk përfshin informata të tjera dhe, përveç nëse shprehet ndryshe në raportin tonë, ne nuk shprehim asnjë lloj përfundim sigurie lidhur me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informata të tjera dhe duke vepruar kështu të konsiderojmë nëse Informata të tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim, ose përndryshe duket të jetë keq-deklaruar materialisht. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, vijmë në përfundim se ekziston një keqdeklarim material i Informatave të tjera, ne na kërkohet të raportojmë atë fakt. Në këtë kuptim, ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijmësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.



Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënimet	2021	2020
<i>Në mijë Euro</i>			
Të ardhurat nga interesi	5	17,263	15,589
Shpenzimet e interesit	5	(2,015)	(2,287)
Të ardhurat neto nga interesi		15,248	13,302
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	6	4,178	3,524
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet	6	(2,024)	(1,738)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		2,154	1,786
Kthimi nga kreditë e shlyera		543	475
Fitimi neto nga këmbimi valutor		54	39
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		1,010	510
Gjithsej të ardhurat operative		19,009	16,112
Të ardhurat tjera	7	383	163
Shpenzimet e humbjes kreditore dhe paradhëniet për klientë	14	(1,228)	(3,042)
Shpenzimet e humbjes kreditore për pasuritë financiare	10-13	(139)	(20)
Rënia e vlerës së pasurive të riposeduara	18.1	(171)	(161)
Provizionet tjera		(7)	(129)
Shpenzimet tjera operative	8	(9,222)	(7,864)
Fitimi para tatimit në fitim		8,625	5,059
Shpenzimet e tatimit në fitim	9	(748)	(530)
Fitimi neto per vitin		7,877	4,529
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që janë apo mund të riklasifikohen në fitim ose humbje			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse		569	(26)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		8,446	4,503
Fitimi për aksion (në mijë EURO)	25	0.30	0.16

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2021

Në mijë Euro	Shënimet	2021	2020
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në Banka	10	26,427	25,082
Gjendja në Bankën Qendrore të Kosovës	11	61,530	52,465
Plasmanet dhe balancat në Banka	12	5,237	5,261
Letrat me vlerë të mbajtura për shitje	13	47,620	53,535
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	14	232,234	192,656
Pasuritë tjera financiare	15	265	272
Pasuritë e paprekshme	16	688	605
Prona dhe pajisjet	17	2,513	2,318
E drejta e përdorimit të pasurive	23	2,378	2,553
Pasuri e shtyrë tatimore	9	7	-
Pasuritë tjera	18	260	151
Gjithsej Pasuritë		379,159	334,898
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	19	319,614	286,022
Depozitat nga bankat	20	2,533	2,861
Kreditë e varura	21	502	502
Huamarrjet	22	6,832	4,074
Detyrimet ndaj qirave	23	2,452	2,612
Provizionet	24	523	511
Detyrimi i tatimit të shtyrë	9	-	20
Detyrimet tjera	24	4,235	2,689
Gjithsej detyrimet		336,691	299,291
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	25	11,247	11,247
Rezervat tjera të kapitalit	25	769	769
Rezerva e rivlerësimit	25	96	96
Rezerva për vlerën e drejtë		519	(93)
Fitimi i akumuluar		29,837	23,588
Gjithsej ekuiteti		42,468	35,607
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		379,159	334,898

Këto Pasqyra Financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës me 25 Mars 2022 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Arton Celina
Kryeshet Ekzekutiv

Gresa Godeni
Udhëheqëse e Departamentit të Financave

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali aksionar	Rezervat tjera të kapitalit	Rezervat e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i mbajtur	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>						
Gjendja më 1 janar 2020	11,247	769	96	(67)	19,059	31,104
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	4,529	4,529
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 13.1)	-	-	-	(26)	-	(26)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(26)	4,529	4,503
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2020	11,247	769	96	(93)	23,588	35,607
Gjendja më 1 janar 2021	11,247	769	96	(93)	23,588	35,607
Gjendja më 1 janar 2021 - Korrigjuar	-	-	-	43	-	43
Gjendja më 1 janar 2021 - Pas korrigjimit	11,247	769	96	(50)	23,588	35,650
Fitimi i vitit	-	-	-	-	7,877	7,877
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 13.1)	-	-	-	569	-	569
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	-	569	7,877	8,446
Shpërndarja e dividendës	-	-	-	-	(1,628)	(1,628)
Gjendja me 31 dhjetor 2021	11,247	769	96	519	29,837	42,468

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

<i>Në mijë Euro</i>	Note	2021	2020
Rrjedhja e Parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		8,625	5,059
Rregulluar për:			
Amortizimi	16	321	225
Zhvlerësimi	17	760	753
Efekti i tranzicionit të rregullimit në SNRF 9		-	(857)
Fitimi nga shitja e pronave, pajisjeve dhe pasurive të riposeduara		(94)	(1)
Fitimi nga kolaterali i riposeduar		(266)	(110)
Humbjet nga provizionet e kredive	14	1,228	3,042
Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive financiare		139	20
Rënia në vlerë për pasuritë e riposeduara	18.1	171	161
Privizionet tjera		7	129
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(1,010)	(510)
Shpenzimet e interesit	5	2,015	2,287
Të ardhurat nga interesi	5	(17,263)	(15,589)
		(5,367)	(5,391)
Ndryshimet në:			
Kreditë dhe paradhëniet për banka	12	(4)	792
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	14	(39,529)	(12,240)
Rezerva e detyrueshme në BQK	11	(3,217)	(4,017)
Pasuritë tjera	18	(110)	21
Pasuritë tjera financiare	15	6	(66)
Depozitat nga klientët	19	33,163	34,788
Detyrimet dhe provizionet tjera		2,127	1,303
Të hyrat nga shitja e pasurive të riposeduara		260	110
Paraja e gjeneruar nga aktiviteti operativ		(12,671)	15,300
Interesi i arkëtuar		17,164	15,618
Interesi i paguar		(1,992)	(2,121)
Tatimi në fitim i paguar	9	(619)	(570)
Rregullimi i tatimit mbi të ardhurat		162	-
Pasuri e shtyer tatimore		(7)	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		2,037	28,227
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Shitja e letrave me vlerë të mbajtuara për shitje		50,086	24,631
Blerja e letrave me vlerë të mbajtuara për shitje		(44,128)	(39,532)
Blerja e pasurive të paprekshme	16	(381)	(315)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	17	(978)	(217)
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve	16	94	-
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		4,693	(15,432)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Detyrimet e qirasë		(748)	(656)
Pagesa e huamarrjeve	20	(2,219)	(2,486)
Inkasimet nga huamarrjet	20	5,000	253
Dividenda e shpërndarë		(1,628)	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		405	(2,889)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		7,135	9,909
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	10	52,921	43,012
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	10	60,056	52,921

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 29 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

1. HYRJE

Banka për Biznes Sh.a. e njohur më parë si Banka Private e Biznesit Sh.a. ka marrë licencën për aktivitete bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve dhe 19 nëndegëve të saj të vendosura në tërë Kosovën (2020: 7 degëve dhe 19 nëndegë).

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 ishin autorizuar për t'u lëshuar në pajtim me vendimin e drejtorëve më 25 mars 2022.

2. BAZAT E PËRGADITJES

2.1 Bazat e Kontabilitetit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç pasqyrave financiare të listuara më poshtë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura nën modelin e biznesit të mbajtur për mbledhje dhe shitje.

Ndryshimet në lidhje me politikat e rëndësishme të kontabilitetit përshkruhen në Shënimin nr. 3. Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2020 dhe 2021.

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur parimin e vijimësisë së biznesit. Më shumë informacione në lidhje me rrethanat e shkaktuara nga pandemia globale e COVID-19 që ndikuan në operacionet dhe aktivitetet e Bankës në vitin 2021 dhe Konflikti në Ukrainë shpalosen në Shënimin 27 dhe 29. Këto rrethana nuk ndikuan në përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë së biznesit të Bankës.

2.3 Standardet e reja dhe të rishikuara dhe interpretimi i tyre

2.3.1 Standardet efektive, ndryshimet në standarde dhe zbatimet në vitin 2020

Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2021 dhe janë të zbatueshme për Bankën janë:

- Koncesione të lidhura me qiranë si pasojë e COVID-19 pas datës 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16);
- Reforma e Standardit Krahases të Normës së Interesit Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16)

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpalosje.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**2.3 Standardet e reja dhe te ndryshuara dhe interpretimi i tyre (vazhdim)****2.3.2 Standardet, ndryshimet në standarde dhe interpretimet e lëshuara por që nuk janë ende efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por që nuk janë ende efektive, dhe ndryshime në Standardet dhe Interpretimet ekzistuese janë publikuar nga BSNK si më poshtë:

- SNRF 17: Kontratat e Sigurimeve;
- Ndryshimet në SNRF 17: Kontratat e Sigurimeve (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4);
- Referencat ndaj Kornizës Konceptuale;
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16);
- Kontratat e ngarkuara – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37);
- Përmirësimet vjetore të Ciklit të Standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41);
- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo-rrjedhëse (ndryshimet në SNK 1);
- Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet nga një transaksion i vetëm;

Asnjë nga këto standarde apo ndryshime në standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga Banka. Menaxhmenti parashikon që të gjitha njoftimet janë të adaptuara për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë shpalosur pasi nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

2.4 Monedha funksionale dhe prezantuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në EURO, e cila është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç kur specifikohet ndryshe.

2.5 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave të kontabilitetit të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësime njihen në mënyrë të mundshme.

Informacioni në lidhje me fushat domethënëse të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave të kontabilitetit që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 3, 4 dhe 27.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. "Norma efektive e interesit" është ajo normë që diskonton saktësisht pagesa të ardhshme të parave të gatshme ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) për:

- vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat e ardhshme të pasasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme kreditore. Për pasuritë financiare të rëna në vlerë, një normë efektive e interesit të rregulluar nga kredia llogaritet duke përdorur rrjedhat e ardhshme të vlerësuar të pasasë duke përfshirë humbjet e pritshme kreditore.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinë të gjitha kostot e transaksionit të tarifave dhe komisionet dhe zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të pasurive (kur pasuritë nuk janë të rëna në vlerë) ose në koston e amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, për pasuritë financiare që kanë pasur rënie në vlerën kreditore pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare. Nëse pasuria nuk është më e rënë në vlerën kreditore, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto.

Për pasuritë financiare të cilat kanë rënë në vlerën kreditore në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të pasurisë. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto, edhe nëse risku kreditor i pasurisë përmirësohet.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) përfshijnë:

- interesin nga pasuritë dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv;
- interesi nga instrumentet e borxhit të matur në VDATGJ të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

b) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e larmishme e shërbimeve financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një shumë që reflekton konsideratën në të cilën Banka pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e plotësimit të tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumta të performancës.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**b) Tarifat dhe komisionet (vazhdim)**

Shërbimet që Banka ofron për klientët e saj, duhet të paguhen menjëherë pas përmbushjes së një shërbimi në një moment të caktuar.

Banka në përgjithësi ka konkluduar se janë thelbësore kontratat e saj të të ardhurave sepse zakonisht i kontrollojnë shërbimet përpara se t'i transferojë ato tek klienti.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimin të shërbimit.

c) Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit.

Në fillim ose në modifikimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Banka cakton konsideratë në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit të saj relativ të pavarur. Sidoqoftë, për qiradhëniet e degëve dhe ambienteve të zyrave, Banka ka zgjedhur që të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe llogaritë për përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë si një përbërës i vetëm i qirasë.

Banka njeh një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurisë fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të kryer dhe një vlerësim të kostove për të demoluar dhe hequr çdo përmirësim i bërë në degë ose ambiente zyre.

E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirasë. Për më tepër, e drejta e përdorimit të pasurisë reduktohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për disa matje të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, zbriten duke përdorur normën inkrementale të interesit në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, norma rritëse e huamarrjes së Bankës. Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj të huamarrjes si normë skontimi.

Banka përcakton normën e saj të huamarrjes duke analizuar huazimet e saj nga burime të ndryshme të jashtme dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar kushtet e qirasë dhe llojin e pasurisë të marrë me qira.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë sa vijon:

- pagesa fikse, përfshirë pagesat fikse në thelb;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit nën një opsion blerjeje që Banka është e arsyeshme e sigurt për të ushtruar, pagesa me qira në një periudhë opsionale rinovimi nëse Banka është e sigurt se do të ushtrojë një mundësi zgjatjeje dhe gjobat për përfundimin e parakohshëm të një qiraje përveç nëse Banka është e arsyeshme e sigurt të mos përfundojë në fillim të vitit 2021.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**c) Qiratë (vazhdim)**

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo ri-vlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës të shumës që pritët të paguhet nën një garancion të vlerës së mbetur, nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj nëse do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje, përfundimi ose nëse ka një pagesë fikse të rishikuar të qirasë.

Kur detyrimi i qirasë ri-vlerësohet në këtë mënyrë, një rregullim përkatës bëhet në vlerën kontabël të së drejtës së përdorimit të pasurisë, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e së drejtës së përdorimit të pasurisë është zvogëluar në zero.

Banka paraqet të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimet e qirasë në Shënimin 23 dhe veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët

Banka ka zgjedhur të mos njohë të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimeve të qirave për qiratë me vlerë të ulët dhe afatshkurtra, duke përfshirë qiranë e pajisjeve të IT-së. Banka njeh pagesat e qirasë të shoqëruara me këto qira si një shpenzim mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

d) Shpenzimet e tatimit

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritët të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

Pasuritë dhe detyrimet aktuale tatimore kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kriteret e caktuara.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritët të paguhet ose i arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin me rastin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikojnë as në fitimin, as në humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta përcjellin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**d) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)***(ii) Tatimi i shtyer (vazhdim)*

Tatimet shitesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pashfrytëzuara, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shitesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date.

Fitimi ose humbja nga zërat monetar është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës si dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare*(i) Njohja dhe matja fillestare*

Banka fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit, huazimet dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato janë origjinuar. Të gjitha instrumentet e tjerë financiarë (përfshirë blerjet në rrugë të rregullt dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtisë, që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të këtij instrumenti.

Një pasuri ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një zë jo në VDATGJ, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij. Vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i tij i transaksionit. Shikoni Shënimin f) vii) për një përshkrim të politikës nëse vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit.

*(ii) Klasifikimi***Pasuritë financiare**

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si e matur me: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDPFH.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhat kontraktuale të parasë dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për shitje, Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Kjo zgjedhje bëhen në bazë të investimeve për investime.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 të gjitha pasuritë financiare të bankës klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose në VDATGJ.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka bën një vlerësim të objektivit të një modeli biznesi në të cilin një pasuri është mbajtur në një nivel të portofolit, sepse kjo më së miri reflekton mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe i jepet informacioni menaxhmentit. Informacioni i konsideruar përfshinë:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhmentit fokusohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato pasuri ose realizimin e rrjedhës së parasë nëpërmjet shitjes së pasurive;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit të menaxhmentit të Bankës;
- risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda modelit të biznesit) dhe si menaxhohen ato risqe;
- se si menaxherët e biznesit janë kompensuar - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose rrjedhat së parasë kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritshmëritë e tij për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk konsiderohet veç e veç, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si është arritur objektivi i Bankës për menaxhimin e pasurive financiare dhe si realizohen rrjedha të parasë.

Banka nuk mban ndonjë pasuri financiare që mbahet për tregtim ose menaxhim dhe performanca e të cilave vlerësohet sipas VDPFH.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)***3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)*****Vlerësimi nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit***

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principalit' përcaktohet si vlera e drejtë e pasurisë financiare në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si një shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për riskun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risiqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. risku i likuiditetit dhe kostot administrative) si dhe për marzhën e fitimit.

Në vlerësimin nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë vlerësimin nëse pasuritë financiare përmbajnë një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhës kontraktuale të parasë në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë marrjes së vlerësimit, Banka konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin sasinë dhe kohën e rrjedhave të parasë;
- karakteristikat e borxhit;
- parapagimi dhe afatet e zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Bankës për rrjedhat e parasë nga pasuritë e specifikuara; dhe
- karakteristika që ndryshojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë - p.sh., rivendosjen periodike të normave të interesit.

Banka ka një portofol kredie afatgjatë me normë fikse për të cilën Banka ka mundësi të propozojë rishikimin e normës së interesit në datat e rivendosjes periodike. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një mundësi që të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë huanë në parim pa dënim. Banka ka përcaktuar që rrjedhat kontraktuale të parasë të këtyre kredive janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që është konsideratë për vlerën kohore të parasë, riskun e kredisë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumat kryesore të papaguara

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

(iii) Ç'regjistrimi***Pasuritë financiare***

Banka ç'regjiston një pasuri financiare, të tillë si një hua për një klient, kur kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose si humbje e ç'regjistrimit. Gjatë vlerësimit se a do të ç'regjistrohet një pasuri financiare, Banka konsideron faktorët kualitativ dhe kuantitativ. Një ndër faktorët kyç gjatë vlerësimit të ç'regjistrimit të pasurisë financiare është tejkalimi i pragut 10% i vlerës bruto të asetit të modifikuar financiar kundrejt vlerës bruto të asetit origjinal (para modifikimit).

Në momentin e ç'regjistrimit, pasuria financiare e modifikuar njihet si pasuri e re e matur fillimisht me vlerën e tij të drejtë plus kostot e pranueshme të transaksionit. Njohja e pasurisë së re financiare nënkupton matjen e humbjeve të pritshme kreditore 12-mujore përderisa nuk janë plotësuar kërkesat për njohjen e humbjeve të pritshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Ka raste kur pasuria financiare e modifikuar është e zhvlerësuar në njohjen e saj fillestare, ku në raste të tilla këto pasuri njihen si POCI.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)***3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)****(iii) Ç'regjistrim (vazhdim)****Pasuritë financiare (vazhdim)**

Nëse modifikimi nuk rezulton në rrjedhat e parasë që në thelb janë të ndryshme, ku Banka përdor pragun prej 10%, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim. Në këtë rast, Banka rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe një shumën që vjen nga modifikimi si fitim apo humbje në pasqyrën e të ardhurave. Për njohjen e fitimit apo humbjes, Banka skonton rrjedhat e parasë të pasurisë financiare të modifikuar dhe pasurisë financiare fillestare me normën origjinale të interesit efektiv.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale të kthimit në pasuritë e transferuara, transaksioni trajtohet si një transaksion financimi i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e shitjeve dhe të riblerjes, sepse Banka mban të gjitha ose në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë së këtyre pasurive.

Detyrimet Financiare

Banka ç'regjiston një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Modifikimet e pasurive dhe detyrimeve financiare**Pasuritë financiare**

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Banka vlerëson nëse rrjedhat kontraktuale të parasë të pasurisë së modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse rrjedhat e parasë janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në rrjedhat e parasë nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skadar.

Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale ç'regjistrohen dhe një pasuri financiare e re njihet me vlerën e drejtë.

Në këtë rast, pasuria fillestare financiare ç'regjistrohet dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë plus çdo kosto të pranueshme të transaksionit. Çdo tarifë e marrë si pjesë e modifikimit llogaritet si më poshtë:

- Tarifat që merren parasysh në përcaktimin e vlerës së drejtë të pasurisë së re dhe tarifat që përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në matjen fillestare të pasurisë; dhe
- Tarifat e tjera përfshihen në fitim ose humbje si pjesë e fitimit ose humbjes nga ç'regjistrimi.

Nëse rrjedhat e parasë së pasurisë së modifikuar të bartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, banka rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe një shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikuar në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga rënia në vlerë. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

Detyrimet financiare

Banka ç'regjiston një detyrim financiar kur kushtet dhe rrjedhat e parasë të atij detyrimi ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast, detyrimi i ri financiar bazohet me kushtet e reja të ndryshuara në vlerën e tij të drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar që ç'regjistrohet dhe shumës së paguar njihet si fitim ose humbje.

Konsiderata e paguar përfshin pasuritë jo-financiare të transferuara, nëse ka, dhe supozimit të detyrimit, duke përfshirë ndryshim e ri të detyrimit financiar.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)*****Detyrimet financiare (vazhdim)***

Nëse ndryshimi i detyrimit financiar nuk llogaritet si ç'regjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rikalkulohet duke zvogëluar rrjedhat e parasë në normën efektive origjinale të interesit dhe shuma e fituar ose e humbur, regjistrohet si fitim ose humbje.

Për detyrimet financiare me normë të ndryshueshme, norma efektive origjinale e interesit e përdorur për të kalkuluar ndryshimet në fitim ose humbje rregullohet ashtu që të reflektojë kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Çdo kosto dhe tarifë e shkaktuar njihet si një rregullim i vlerës kontabël të detyrimit dhe amortizohet gjatë periudhës së mbetur të detyrimit financiar të modifikuar duke rillogaritur normën efektive të interesit në këtë instrument.

(v) *Netimi*

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercial i bankës.

(vi) *Matja me kosto të amortizuar*

'Kosto e amortizuar' e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, dhe për pasuritë financiare të rregulluara për ndonjë zbritje të pritshme të humbjes nga kreditë. "Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare" është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të korrigjohet për çdo zbritje të humbjes së pritshme kreditore.

(vii) *Matja me vlerë të drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka përcakton vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në tregun aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit – për shembull; vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Kreditë e rëna në vlerë janë kredi për të cilat Banka konstaton se është e mundur që nuk do të mund të mbledhë borxhin dhe interesin sipas kushteve kontraktuale të kredisë. Këto kredi kategorizohen nga A-ja tek E-ja në sistemin e brendshëm të Bankës për vlerësimin e kredive, ku A është Standarde, kurse E është Humbje. Politika e provizionit të këtyre kredive është detajuar në shënimin 3(f)

Vlerësimi individual dhe kolektiv i portofolios së kredive

Për qëllime të menaxhimit të brendshëm, Banka ndan kreditë në kredi që janë vlerësuar individualisht për rënie në vlerë; këto kredi janë të klasifikuara në Fazën 3 dhe me ekspozim mbi 100 mijë euro. Të gjitha kreditë e tjera menaxhohen kolektivisht për qëllime të brendshme të rënies në vlerë.

Kreditë me vonesa por jo të rëna në vlerë

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku pagesat e interesit dhe principalit janë me vonesë, por Banka beson se rënia në vlerë nuk është i përshtatshëm në nivel letrë me vlerë/kolaterali të vlefshëm dhe /ose në nivel grumbullimi të shumave që i detyrohen Bankës.

Kreditë me kushte të ristrukturuara

Kreditë me kushte të ristrukturuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit ku Banka ka bërë koncesione të cilat në rrethana tjera nuk do ti merrte në konsideratë.

Politika e shlyerjes

Banka shlyen një kredi (dhe çfarëdo provizioni për humbje të saj) në përputhje me rregulloret e BQK për kreditë e shlyera që është në fuqi Gjithsej shuma e kredive të shlyera në jashtëbilancoreve gjatë vitit 2021 është 1,198 mijë Euro (2020: 1,016 mijë Euro).

Balancat me bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër në baza ditore nga ana e menaxhimit të riskut dhe Departamentit të Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare në bankat lokale apo ndërkombëtare. Para se të fillojë një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Riskut kryejnë analiza të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime në investime, monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor (S & P), Fitch dhe Moody.

Në përputhje me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka nuk do të ketë asnjë ekspozim agregat të riskut të kreditimit të palëve të lidhura që tejkalon 15% të Kapitalit Rregullator të nivelit të parë.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.2 Risku kreditor (vazhdim)

27.2.2 Analiza e cliësisë kreditore (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të bankës dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas vlerësimit kreditor:

	2021	2020
A+ to A-	3,094	3,247
BBB+ to B-	1,008	1,036
Not rated	10,229	10,430
At 31 dhjetor	14,331	14,713

Zotimet e kreditimit dhe garancionet financiare

Ekspozimi maksimal nga garancionet financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë në qoftë se garancioni është kërkuar, e cila mund të jetë dukshëm më e madhe se shumata e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për kreditimin e angazhimeve është shumata e zotuar.

Kontrolli i riskut të limiteve dhe politikat e menaxhimit

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon përqendrimet e riskut të kredisë kudo që ato janë të identifikuar në mënyrë të veçantë të palët individuale, grupet dhe të njësitë.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës të vetëm ose një grupi huamarrësish dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Risqet e tilla janë të monitoruara në mënyrë të rregullt dhe në bazë të një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë menaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit potencial për të përmbushur pagesat e interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi kur është e nevojshme. Kontrollat e tjera dhe masat zbutëse janë të përshkruara më poshtë.

Kolaterali i mbajtur, përmirësime të tjera të kredisë dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral për kreditë dhe paradhëniet për konsumatorët në formën e interesave të hipotekës mbi pronën dhe pasuritë e tjera të luajtshme. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes. Përgjithësisht nuk mbahet kolateral mbi kreditë dhe paradhëniet për bankat.

Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të sigurisë ndaj pasurive financiare tregohet mëposhtë:

Kreditë dhe paradhëniet për klientë	Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor		Kesh Kolateral		Gjithsej kolaterali i përdorur		Ekspozimet neto pa kolateral
	Prona			Pajisje	Kolateral i tepërt		
31 dhjetor 2021	232,234	320,877	3,660	143,911	468,448	332,154	95,940
31 dhjetor 2020	193,169	281,652	3,991	118,256	403,899	282,579	71,849

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.2 Risku kreditor (vazhdim)****27.2.3 Koncentrimi i riskut kreditor**

Banka monitoron përqendrimin e riskut kreditor për sektor dhe për shpërndarje gjeografike. Një analizë e përqendrimit të riskut kreditor në datën e raportimit është paraqitur si në vijim;

	Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në		Kreditë dhe paradhëniet bankat		Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes OCI		Kreditë dhe paradhëniet klientëve		Pasuritë tjera financiare		Garancionet financiare	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Koncentrimi sipas sektorëve												
Korporatë	-	-	-	-	-	-	122,889	106,124	-	-	11,046	10,612
Banka	87,957	77,547	5,237	5,261	47,620	53,535	-	-	-	-	-	-
Individuale	-	-	-	-	-	-	109,345	86,532	265	272	-	-
Gjithsej	87,957	77,547	5,237	5,261	47,620	53,535	232,234	192,656	265	272	11,046	10,612
Koncentrimi sipas vendit												
Vendet e EU	3,468	4,078	125	205	-	-	-	-	-	-	-	-
Republika e Kosovës	83,667	73,298	5,112	5,056	47,620	53,535	232,234	192,656	265	272	11,046	10,612
Vendet tjera	822	171	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	87,957	77,547	5,237	5,261	47,620	53,535	232,234	192,656	265	272	11,046	10,612

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, sikurse janë normat e interesit, çmimi i kapitalit dhe normat e këmbimit të valutave të huaja do të ndikojnë të hyrat e Bankës apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin nga risku. Tregu përkatës i riskut me të cilin merret banka është risku i valutave të huaja dhe risku i normës së interesit dhe këto risqe menaxhohen në përputhje me politikat e tyre përkatëse.

27.3.1 Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit është risku i humbjeve për shkak të luhatjes së normave të interesit në instrumentet financiare dhe kryesisht është si rezultat i mospërputhjeve të maturimit midis pasurive dhe detyrimeve. Rrjedhimisht, kjo mund të rrisë kostot e financimit të Bankës në krahasim me kthimin e përfituar nga pasuritë të cilat mund të mbeten të pandryshuara dhe kështu, potencialisht të zvogëlojnë margjinën e interesit.

Për të parandaluar këtë risk, Banka mat dhe monitoron riskun e normës së interesit bazuar në analizën e hendekut të çmimit ndërmjet pasurive dhe detyrimeve në mënyrë që të kufizojë ekspozimin ndaj këtij risku dhe të sigurojë përputhjen me rregulloren e BQK-së mbi riskun e normës së interesit në evidencat kontabël i cili është zbatuar që nga 1 janari 2017. Me qëllim të matjes së riskut të normës së interesit, pasuritë dhe detyrimet e bankës shpërndahen brenda periudhave kohore sipas maturimit të tyre dhe pastaj analizohen hendeku i maturitetit dhe i çmimit. Hendeku i normës së interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo standard të normave të interesit. Këta skenarë synojnë të simulojnë luhatjet e normave të interesit për të matur ndikimin mbi rezultatin financiar dhe kapitalin e bankave. Skenarët standard përfshijnë një zhvendosje paralele 2% në lakorën e yield-eve siç kërkohet nga rregullorja e BQK-së. Rezultatet nga këta skenarë raportohen në baza mujore për Komitetin e Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit të Bankës ("LRMC") dhe në baza tremujore tek Komiteti i Riskut në nivelin e bordit. Si rezultat, ekspozimi i bankës ndaj riskut të normës së interesit mbetet në përputhje me profilin e riskut të bankës dhe brenda kufijve të brendshëm dhe rregullatorë të përcaktuar nga BQK-ja.

Normat mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si në vijim:

	<i>dollar</i>		<i>euro</i>	
	2021	2020	2021	2020
Pasuritë				
Paraja në banka	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet bankave	0.20%	0.13%	1.06%	1.40%
Kreditë të klientët	-	-	6.92%	7.25%
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	2.16%	2.36%
Detyrimet				
Depozitat e klientëve	-	-	1.42%	1.44%
Kreditë e varura	-	-	6.50%	6.50%
Huamarrjet	-	-	2.13%	2.69%

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)***27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****27.3 Risku i tregut (vazhdim)****27.3.1 Risku i normës së intersit (vazhdim)**

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar lëvizje simetrike në lakoren e përqindjeve dhe një pozitë financiare stabile) është si vijon:

2021	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i përllogaritur i fitimit (humbjes)	(1,221)	1,221	1,532	(1,532)
2020	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i përllogaritur i fitimit (humbjes)	(1,118)	1,118	1,342	(1,342)

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3 Riksu i tregut (vazhdim)

27.3.1 Risku i normës së intersit (vazhdim)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së ri-çmimit.

31 dhjetor 2021		Deri 1 Muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka							
Që nuk sjellin interes		24,197	-	-	-	-	24,197
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	2,230	-	-	-	-	2,230
Gjendja me BQK							
Që nuk sjellin interes		61,530	-	-	-	-	61,530
Kreditë dhe paradhëniet bankave							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	-	-	10	5,162	65	5,237
Letrat me vlerë							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	142	160	38	3,314	43,966	47,620
Kreditë për klientë							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	8,063	13,148	16,327	37,339	157,357	232,234
Pasuri të tjera financiare							
Që nuk sjellin interes		265	-	-	-	-	265
Gjithsej		96,427	13,308	16,375	45,815	201,388	373,313
Detyrimet							
Depozita të klientëve							
Që bartin interes	<i>Fikse</i>	29,390	10,753	13,391	56,138	41,097	150,769
Që nuk bartin interes		168,845	-	-	-	-	168,845
Detyrime ndaj bankave							
Që bartin interes		-	-	-	-	-	-
Që nuk bartin interes		2,533	-	-	-	-	2,533
Kreditë e varura							
Që bartin interes	<i>Fikse</i>	-	-	2	-	500	502
Huamarrjet							
Që bartin interes	<i>Variable</i>	-	252	-	-	6,580	6,832
Detyrimet tjera							
Që nuk bartin interes		4,235	-	-	-	-	4,235
Gjithsej		205,003	11,005	13,393	56,138	48,177	333,716
Hendeku		(108,576)	2,303	2,982	(10,323)	153,211	39,597
Hendeku kumulativ		(108,576)	(106,273)	(103,291)	(113,614)	39,597	-

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3 Risku i tregut (vazhdim)

27.3.1 Risku i normës së interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2020		Deri 1 Muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë							
Para e gatshme dhe në banka							
Që nuk sjellin interes		22,910	-	-	-	-	22,910
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	2,172	-	-	-	-	2,172
Gjendja me BQK							
Që nuk sjellin interes		52,465	-	-	-	-	52,465
Kreditë dhe paradhëniet bankave							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	80	-	-	5,171	10	5,261
Letrat me vlerë							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	1	224	57	298	52,955	53,535
Kreditë për klientë							
Që sjellin interes	<i>Fikse</i>	5,166	12,447	12,093	34,690	126,889	191,285
Pasuri të tjera financiare							
Që nuk sjellin interes		272	-	-	-	-	272
Gjithsej		83,066	12,671	12,150	40,159	179,854	327,900
Detyrimet							
Depozita të klientëve							
Që bartin interes	<i>Fikse</i>	24,591	12,419	12,409	49,246	41,992	140,657
Që nuk bartin interes		145,365	-	-	-	-	145,365
Detyrime ndaj bankave							
Që bartin interes		-	-	-	-	-	-
Që nuk bartin interes		2,861	-	-	-	-	2,861
Kreditë e varura							
Që bartin interes	<i>Fikse</i>	-	-	2	-	500	502
Huamarrjet							
Që bartin interes	<i>Variabile</i>	-	-	185	290	3,599	4,074
Detyrimet tjera							
Që nuk bartin interes		2,689	-	-	-	-	2,689
Gjithsej		175,506	12,419	12,596	49,536	46,091	296,148
Hendeku		(92,440)	252	(446)	(9,377)	133,763	31,752
Hendeku kumulativ		(92,440)	(92,188)	(92,634)	(102,011)	31,752	-

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3 Risku i tregut (vazhdim)

27.3.2 Ekspozimi ndaj riskut valutor

Risku valutor është risku i humbjeve të mundshme nga pozicioni i hapur në valutë të huaja për shkak të luhatjeve në kursin e këmbimit. Banka është e ekspozuar ndaj riskut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Banka sigurohet që ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke blerë apo shitur valuta të huaja aty për aty kur është e nevojshme për të zgjidhur bilancet afat-shkurtra. Banka menaxhon dhe monitoron riskun valutor kundrejt limiteve të përcaktuar në politikën e riskut dhe në rregulloren e BQK-së për Riskun e Këmbimit Valutor. Ekspozimi ndaj riskut valutor diskutohet dhe raportohet në baza mujore për komitetin e likuiditetit dhe të riskut të tregut. Valutat e huaja me të cilat merret Banka janë kryesisht dollari amerikan (USD), frangu zviceran (CHF), dhe funta e Britanisë së Madhe (GBP). Normat e përdorura për konvertim më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Valuta	2021	2020
	EURO	EURO
1 USD	0.8829	0.8149
1 CHF	0.968	0.9258
1 GBP	1.1901	1.1123

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës kundrejt rritjes apo zbritjes në normat e konvertimit me valuta të huaja është si ne vijim:

	USD		CHF		GBP	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitim apo humbje						
+5% of Euro	(22.75)	(28.29)	(2.64)	(19.50)	1.05	1.07
- 5% of Euro	22.75	28.29	2.64	19.50	(1.05)	(1.07)

Ekspozimi i bankës kundrejt riskut të valutave të huaja është si në vijim:

31 dhjetor 2021	EURO	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja e gatshme dhe në banka	24,932	855	619	21	26,427
Gjendja me BQK	61,530	-	-	-	61,530
Kreditë dhe paradhëniet për banka	47,620	-	-	-	47,620
Kreditë dhe paradhëniet për klientë - rilëshuar	3,314	-	1,923	-	5,237
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë	232,234	-	-	-	232,234
Pasuritë tjera financiare	265	-	-	-	265
Gjithsej	369,895	855	2,542	21	373,313
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	315,710	1,310	2,594	-	319,614
Detyrimet ndaj bankave	2,533	-	-	-	2,533
Kreditë e varura	502	-	-	-	502
Huamarrjet	6,832	-	-	-	6,832
Detyrime tjera	4,235	-	-	-	4,235
Gjithsej detyrimet financiare	329,812	1,310	2,594	0	333,716
Pozita e valutave të huaja, neto	40,083	(455)	(52)	21	39,597

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.3 Risku i tregut (vazhdim)****27.3.2 Ekspozimi ndaj riskut valuator (vazhdim)**

31 dhjetor 2020	EURO	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja e gatshme dhe në banka	23,255	950	856	21	25,082
Gjendja me BQK	52,465	-	-	-	52,465
Kreditë dhe paradhëniet për banka	53,535	-	-	-	53,535
Kreditë dhe paradhëniet për klientë - rilëshuar	3,413	-	1,848	-	5,261
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë	192,656	-	-	-	192,656
Pasuritë tjera financiare	272	-	-	-	272
Gjithsej	325,596	950	2,704	21	329,271
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	281,412	1,516	3,094	-	286,022
Detyrimet ndaj bankave	2,861	-	-	-	2,861
Kreditë e varura	502	-	-	-	502
Huamarrjet	4,074	-	-	-	4,074
Detyrime tjera	2,689	-	-	-	2,689
Gjithsej detyrimet financiare	291,538	1,516	3,094	-	296,148
Pozita e valutave të huaja, neto	34,058	(566)	(390)	21	33,123

27.4 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të ballafaqohet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare me kohë dhe për të përmbushur kërkesat e papritura për fonde nga depozituesit e saj ose nga kreditorët e tjerë.

Për më tepër, risku i likuiditetit përfshinë gjithashtu riskun që banka nuk do të jetë në gjendje të financojë rritjen e pasurive.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet me kohë, sipas kushteve normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës.

Për këtë qëllim, në baza ditore, banka monitoron pozicionin e saj të likuiditetit dhe kushtet e tregut. Për më tepër, vazhdimisht vlerëson riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për të përmbushur objektivat e biznesit dhe objektivat e përcaktuara në aspektin e strategjisë së përgjithshme të Bankës. Përveç kësaj, Banka mban një portofol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së saj të menaxhimit të riskut të likuiditetit.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të riskut të likuiditetit dhe për të siguruar që nuk ndodhin mangësi të likuiditetit, Banka mban bazën e saj të depozitave të diversifikuara. Si i tillë, Banka synon të mbledhë fonde duke përdorur një gamë të gjerë të instrumenteve siç janë depozitat e klientëve ose financimi nga IFN-të, të cilat do të sigurojnë që baza e financimit të mbetet e qëndrueshme.

Përveç raportimit ditor, banka gjithashtu monitoron riskun e likuiditetit në baza mujore. Ky monitorim përfshinë pozicionin e likuiditetit në rrethana normale dhe gjithashtu nën testet e stresit. Rezultatet diskutohen në Komitetin e Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit.

Për më tepër, Banka ka gjithashtu një plan të paparashikueshëm të likuiditetit i cili mundëson menaxhimin efektiv të likuiditetit në rast të rrethanave të papritura

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.4 Risku i likuiditetit (vazhdim)

27.4.1 Menaxhimi i riskut të likuiditetit

Banka mat riskun e likuiditetit duke përdorur analizën e hendekut të likuiditetit i cili paraqet maturitetet e mbetura të pasurive dhe detyrimeve financiare. Maturiteti i mbetur është periudha midis datës kontraktual të pasurive/ detyrimeve dhe datës së bilancit.

Tabelat në vijim tregojnë rrjedhat e parave të paskontuara të detyrimeve financiare të Bankës dhe zotimet dhe garancionet e papërdorura të huasë në bazë të maturimit të tyre më të hershëm të mundshëm kontraktual. Rrjedhat të pritshme të parasë të Bankës të këtyre instrumenteve ndryshojnë shumë nga kjo analizë. Për shembull, llogaritë e kërkesës priten të mbajnë një balancë të qëndrueshme ose në rritje.

31 dhjetor 2021	Deri 1	1 - 3	3 - 6	6 -12	Mbi 12	
	Muaj	Muaj	Muaj	Muaj	Muaj	Gjithsej
Pasuritë financiare						
Paraja e gatshme dhe në banka	26,427	-	-	-	-	26,427
Gjendja me BQK	61,530	-	-	-	-	61,530
Kreditë dhe paradhëniet për banka	-	-	10	5,162	65	5,237
Kreditë dhe paradhëniet për klientë - rilëshuar	8,063	13,148	16,327	37,339	157,357	232,234
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë	142	160	38	3,314	43,966	47,620
Pasuritë tjera financiare	265	-	-	-	-	265
Gjithsej	96,427	13,308	16,375	45,815	201,388	373,313
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	198,235	10,753	13,391	56,138	41,097	319,614
Detyrimet ndaj bankave	2,533	-	-	-	-	2,533
Kreditë e varura	-	-	2	-	500	502
Huamarrjet	-	252	-	-	6,580	6,832
Detyrime tjera	4,235	-	-	-	-	4,235
Garancionet e lëshuara	2,354					2,354
Zotimet për kredi të pashfrytëzuara	8,692					8,692
Gjithsej	216,049	11,005	13,393	56,138	48,177	344,762
Hendeku i likuiditetit	(119,622)	2,303	2,982	(10,323)	153,211	28,551

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.4 Risku i likuiditetit (vazhdim)****27.4.1 Menaxhimi i riskut të likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2020	Deri 1 Muaj	1 - 3 Muaj	3 - 6 Muaj	6 -12 Muaj	Mbi 12 Muaj	Gjithsej
Pasuritë financiare						
Paraja e gatshme dhe në banka	25,082	-	-	-	-	25,082
Gjendja me BQK	52,465	-	-	-	-	52,465
Kreditë dhe paradhëniet për banka	80	-	-	5,171	10	5,261
Kreditë dhe paradhëniet për klientë - rilëshuar	5,798	12,507	12,165	34,870	127,316	192,656
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë	1	224	57	298	52,955	53,535
Pasuritë tjera financiare	272	-	-	-	-	272
Gjithsej	83,698	12,731	12,222	40,339	180,281	329,271
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	169,956	12,419	12,409	49,246	41,992	286,022
Detyrimet ndaj bankave	2,861	-	-	-	-	2,861
Kreditë e varura	-	-	2	-	500	502
Huamarrjet	-	-	185	290	3,599	4,074
Detyrime tjera	2,689	-	-	-	-	2,689
Garancionet e lëshuara	2,062	-	-	-	-	2,062
Zotimet për kredi të pashfrytëzuara	8,551	-	-	-	-	8,551
Gjithsej	186,11	12,419	12,596	49,536	46,091	306,761
Hendeku i likuiditetit	(102,421)	312	(374)	(9,197)	134,190	22,512

27.5 Risku operacional

Në përputhje me rregulloren e BQK-së, risku operacional përcaktohet si risku i humbjes që del nga proceset e papërshtatshme ose të dështuara të brendshme, njerëzit, sistemet ose ngjarjet e jashtme. Ky përkufizim përfshinë riskun ligjor, por përjashton riskun strategjik dhe riskun reputacional. Për të siguruar një menaxhim efektiv të riskut operacional, banka ka implementuar një kornizë të riskut operacional i cili përfshinë politikën dhe procedurat, teknikat dhe mjetet për identifikimin, vlerësimin, parandalimin/ kontrollimin dhe monitorimin e riskut operacional.

Për të përmirësuar dhe rritur efektivitetin e kontroleve të brendshme në proceset e bankës dhe për të regjistruar të gjitha humbjet e riskut operacional, banka ka krijuar një "bazë të dhënash për ngjarjet e humbjes" ku regjistrohen të gjitha ngjarjet që shkaktojnë humbje operationale ose risqe potenciale që mund të shkaktojnë humbje. Kufijtë dhe linjat e raportimit të këtyre humbjeve përcaktohen në politikën e menaxhimit të riskut operacional. Për më tepër, procedura e riskut operacional përshkruan në detaje hapat që banka ndërmerr nga informacioni i mbledhur në bazën e të dhënave të ngjarjeve të riskut operacional.

Kjo bazë e të dhënave konsiderohet të jetë burimi më i mirë i informacionit për zhvillimin e modeleve për matjen e ekspozimit të bankës ndaj riskut operacional pasi ofron informata për shkaqet e humbjes. Për më tepër, nëpërmjet informacionit të mbledhur nga kjo bazë e të dhënave janë vendosur masa korrektuese ose parandaluese për të parandaluar / kontrolluar këtë risk.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)***27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****27.5 Risku operacional (vazhdim)**

Vlerësimi vjetor për proceset e ndryshme në bankë është pjesë e kornizës së menaxhimit të riskut operacional të bankës. Nëpërmjet këtij vlerësimi Banka mbledh informacion të dobishëm për përcaktimin e profilit të riskut operacional të Bankës dhe vlerëson risqet që Banka i'u është ekspozuar, duke përfshirë shkallën e implementimit të kontrollit. Kjo mundëson përmirësimin e proceseve të kontrollit përmes masave të ndryshme, duke reduktuar kështu ndikimin e humbjeve nga risku operacional.

Menaxhimi efektiv i riskut operacional nënkupton njohjen e pozicionit të bankës dhe profilit të riskut. Prandaj, për këtë qëllim, banka përdor treguesit kryesor të riskut (KRIs) për të monitoruar drejtuesit e ekspozimeve të lidhura me risqet kryesore. Këta tregues monitorohen në baza të rregullta (muajore / tremujore) në mënyrë që të lehtësojnë menaxhimin e riskut operacional duke ofruar sinjale paralajmëruese të hershme për ndryshimet që mund të tregojnë shqetësime risku.

Në krijimin e një menaxhimi efektiv të riskut operacional, Banka ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit të riskut kryesisht përmes trajnimeve, të cilat ofrohen për të gjithë stafin e bankës në baza vjetore. Këto trajnime synojnë të rrisin njohuritë lidhur me menaxhimin e riskut operacional përmes diskutimit të skenarëve të ndryshëm në ngjarjet e mëparshme të riskut operacional. Për më tepër, trajnimet adresojnë kanalet përmes të cilave duhet të monitorohen dhe raportohen ngjarjet e riskut operacional.

Përveç kësaj, banka ka zbatuar një proces për të siguruar që ndryshimet në produktet, shërbimet ose proceset (ekzistuese ose të reja) të kalojnë me shqyrtimin dhe miratimin e riskut. Kjo do të sigurojë që risku operacional që vjen nga proceset, produktet ose shërbimet e reja në Bankë të monitorohet dhe të trajtohet menjëherë.

Banka llogarit pagesën e kapitalit për riskun operacional duke përdorur Metodën e Treguesit Bazë (BIA) siç përcaktohet nga rregullorja e Bankës Qendrore mbi Menaxhimin e Riskut Operacional.

27.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Banka menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që Banka do të jetë në gjendje të vazhdojë aktivitetin duke maksimizuar kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të të borxhit dhe ekuitetit.

Struktura e kapitalit neto të Bankës përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimet e mbajtura. Politika e Bankës është të ruajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksionerëve njihet gjithashtu dhe Banka njeh nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve më të larta që mund të jetë e mundur me kthime më të larta dhe avantazheve dhe sigurisë të ofruara nga një pozicion i shëndoshë i kapitalit.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, ndër të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është përqindja e kapitalit rregullator ndaj pasurive të peshuara të rrezikut, e shprehur në përqindje.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit (vazhdim)***Kapitali rregullator (vazhdim)*

Që nga 1 janari 2020 u zbatua rregullorja e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit. Ndryshimet kryesore të zbatuara në këtë rregullore janë në fushat e mëposhtme:

- Struktura e kapitalit - e cila përbëhet nga: kapitali i nivelit 1 (kapitali i zakonshëm i nivelit 1 (CET1) + niveli shtesë i nivelit 1) dhe kapitali i nivelit 2. Në lidhje me CET1, ndikimi kryesor është i dukshëm në llogaritjen e fitimeve të mbajtura, ku fitimet e vitit aktual lejohen të përfshihen në llogaritjen e kapitalit vetëm me miratimin paraprak nga BQK-ja. Ky aprovim i nënshtrohet kritereve të mëposhtme: që ky fitim është verifikuar nga auditorë të jashtëm dhe se shpërndarja e planifikuar e dividendit është marrë parasysh.

Në lidhje me kapitalin, kërkohet që banka të mbajë një prag të ruajtjes së kapitalit prej 2.5% në lidhje me pasuritë e peshuara me Rrezik (RWA).

Gjithsej Kapitali rregullator i bankës përbëhet nga shuma e elementeve të mëposhtme: Kapitali i Nivelit 1 (Kapitali i Përgjithshëm Tier 1 (CET1) dhe Tier 1 shtesë) dhe Kapitali i Tier 2. Raportet minimale të kërkuara të mjaftueshmërisë së kapitalit janë si më poshtë:

- Kapitali i përbashkët i nivelit 1 (CET1) duhet të jetë së paku 4.9% e pasurive të peshuara nga rreziku në çdo kohë.

- Kapitali i nivelit 1 duhet të jetë së paku 9.0% e pasurive të peshuara me rrezik në çdo kohë, duke përfshirë prapën e ruajtjes së kapitalit.

- Kapitali i Përgjithshëm (Kapitali i Tier 1 plus Kapitali i Tier 2) duhet të jetë së paku 12.0% e pasurisë së peshuar nga rreziku në çdo kohë.

Pasuritë e peshuara me rrezik (RWAs)

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke u caktuar një pëshim i rrezikut sipas shumës së kapitalit që konsiderohet i nevojshëm për t'i mbështetur ato.

Ndryshimet kryesore të aplikuara në rregulloren e re për këtë pjesë janë ekspozimi i peshuar nga rreziku - ky ekspozim kërkohet të llogaritet për: rrezikun kreditor, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Sa i përket ekspozimit të peshuar të rrezikut për rrezikun e kredisë u zbatuan këto ndryshime: 15 klasa të ekspozimit u prezantuan, pesha e rrezikut e aplikuar për ekspozimet e rrezikut kreditor të siguruara nga Fondi i Garantimit të Kredisë së Kosovës (KCGF) është 0% dhe kriteret e reja u shtuan për klasifikimin e një ekspozimi si ekspozim me pakicë, ekspozim afatshkurtër dhe afatgjatë, etj.

Sa i përket ekspozimit të matjes së rrezikut për rrezikun e tregut, BQK-ja kërkon të llogarisë kapitalin për këtë lloj rreziku. Sidoqoftë, meqenëse ekspozimi i bankës ndaj këtij rreziku është mjaft i kufizuar vetëm në rrezikun e monedhës dhe pozicioni neto është nën kufirin e 2% të kapitalit rregullator total siç përcaktohet nga BQK-ja, atëherë banka nuk alokon kapital për këtë rrezik. Për sa i përket rrezikut operacional nuk janë bërë ndryshime.

Për qëllimin e llogaritjes së shumave të ekspozimit të ponderuara nga rreziku, banka alokon secilin ekspozim në klasat vijuese që mbajnë pesha nga 0% - 150% RWA në varësi të kritereve të përcaktuara për secilën klasë të ekspozimit:

- ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
- ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale
- ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik
- ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
- ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare
- ekspozimet ndaj institucioneve;

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit (vazhdim)

Pasuritë e peshuara me rrezik (RWAs) (vazhdim)

Për qëllimin e llogaritjes së shumave të ekspozimit të ponderuara nga rreziku, banka alokon secilin ekspozim në klasat vijuese që mbajnë pesha nga 0% - 150% RWA në varësi të kriterëve të përcaktuara për secilën klasë të ekspozimit:

- ekspozimet ndaj korporatave;
- ekspozimet ne tregeti me pakicë;
- ekspozimet e siguruar nga hipotekat në pronë të paluajtshme;
- ekspozimet në parazgjedhje;
- ekspozime të shoqëruara me rrezik veçanërisht të lartë;
- ekspozimet ndaj institucioneve dhe korporatave me një vlerësim të kredisë afatshkurtër;
- ekspozimet në formën e fondeve të investimeve;
- ekspozimet e kapitalit;
- zërat tjerë

Në mënyrë që të sigurohet që Banka qëndron shumë mbi kërkesat minimale për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, Banka ka miratuar një kufi të brendshëm të kapitalit i cili është më i madh se minimumi i caktuar nga BQK-ja. Ky kufi shërben si një tregues i paralajmërimit të hershëm për bankën dhe na ndihmon të sigurojmë menaxhim më të mirë të kapitalit.

	2021	2020
Gjithsej pasuritë e peshuara me risk	213,593	183,075
Gjithsej ekspozimet jashtëbilancore të peshuara me risk	1,024	644
Gjithsej pasuritë e peshuara me risk për riskun operacional	19,535	18,462
Gjithsej	234,152	202,181
Kapitali rregullator (gjithsej kapitali)	42,508	35,901
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali)	18.15%	17.76%

Për të siguruar mjaftueshmërinë e kapitalit, banka ka ndërtuar modele që përcaktojnë kapitalin shtesë të kërkuar sipas Shtyllës II për të mbuluar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet banka siç kërkohej nga Rregullorja e BQK-së për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP).

Për këtë qëllim, banka ka caktuar kapital shtesë për të mbuluar edhe rreziqet e tjera që nuk mbulohen nga Shtylla I në mënyrë që të sigurohet që banka të mbulohet në çdo kohë.

Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas rregullores ICAAP merr parasysh vlerësimin sasior dhe cilësor të rreziqeve që konsiderohen materiale për bankën. Rreziqet e përfshira në Shtyllën 2 janë: rreziku i monedhës, rreziku i normës së interesit, rreziku i koncentruar dhe rreziku i palës tjetër. Sa i përket rreziqeve të tjera, janë përdorur vlerësime cilësore ose janë përdorur supozime të ndryshme.

- Rreziku i koncentruar - për të menaxhuar këtë rrezik dhe për ta analizuar atë në aspektin e alokimit të kapitalit për qëllimet e Shtyllës II, banka përdor indeksin

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit (vazhdim)***Pasuritë e peshuara me rrezik (RWAs) (vazhdim)*

Sa i përket rreziqeve të tjera, janë përdorur vlerësime cilësore ose janë përdorur supozime të ndryshme.

- *Rreziku i koncentruar* - për të menaxhuar këtë rrezik dhe për ta analizuar atë në aspektin e alokimit të kapitalit për qëllimet e Shtyllës II, banka përdor indeksin
- *Herfindahl-Hirschman (HHI)* përmes të cilit përcaktohet përqendrimi i portofolit të kredisë bazuar në sektor, si dhe në nivelin të përqendrimit individual. Rezultatet e kësaj analize përdoren gjithashtu kur analizohen kërkesat e ekspozimit ndaj kredisë, në mënyrë që të sigurohet që banka nuk rrit koncentrimin e saj në një sektor të veçantë ose individ dhe që për pasojë do të duhet të alokojë kapital shtesë si rezultat i kësaj ekspozimi shtesë.
- *Rreziku i palës tjetër* - në lidhje me alokimin e kapitalit sipas Shtyllës II, për të përcaktuar vlerën e ekspozimit ndaj këtij rreziku banka merr parasysh probabilitetin e mospagimit për 1 vit bazuar në vlerësimin e njëres prej agjencive të vlerësimit të kredisë (Fitch, Moody's, S&P) dhe maturiteti i mbetur.
- *Rreziku i normës së interesit në librin bankar (IRRBB)* - për qëllimin e llogaritjes së kapitalit nën Shtyllën II për këtë rrezik, u analizua ndikimi në të ardhurat nga interesi për periudhën 1 vit si rezultat i lëvizjes së normave të interesit me 2%. Pasqyra e pozicionit financiar të bankës që është i ndjeshëm ndaj normave të interesit përbëhet nga aktive që kanë një maturitet më të gjatë se sa detyrimet, prandaj ri-çmimi i detyrimeve ndodh më herët se ai i aktiveve që do të thotë se banka është më e ndjeshme ndaj rritjes së normave të interesit.
- *Rreziku i valutës* - për të llogaritur kapitalin për këtë rrezik, u mor parasysh vlera e pozicionit të hapur në të gjitha monedhat dhe për këtë ekspozim u alokua 12% e shumës së kapitalit, në përputhje me kërkesat e rregullores për mjaftëueshmërinë e kapitalit.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

28. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse njëra prej tyre ka aftësinë për të kontrolluar tjetrën ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi atë që merr vendime financiare dhe operative. Palët e fundit kontrolluese janë aksionarët e listuar në kapitalin dhe rezervat e aksionarëve të Shënimit 23.

Gjatë shqyrtimit të secilës marrëdhënie të mundshme të palëve të lidhura, vëmendja i drejtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës juridike.

Një përmbledhje e bilanceve të palëve të lidhura, në fund të vitit janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
Pasuritë:				
<i>Kreditë aktive në fund të vitit tek aksionarët dhe menaxhmenti kryesor</i>	Faza		Faza	
Aksionaret	Faza 1	1,095	Faza 1	839
	Faza 2	77	Faza 2	-
	Faza 3	127	Faza 3	127
	Gjithsej	1,299	Gjithsej	966
Menaxhmenti	Faza 1	96	Faza 1	129
	Faza 2	-	Faza 1	-
	Faza 3	-	Faza 1	-
	Gjithsej	96	Gjithsej	129
Gjithsej		1,395		1,095
Garancionet dhe leter-kreditë me aksionar	Faza 1	815	Faza 1	814

Kreditë për palët e lidhura jepen në terma komerciale.

	2021	2020
Kreditë për aksionarët, bruto	1,299	966
Lejimet për rënie në vlerë	(133)	(125)
Gjithsej kreditë për aksionarët, neto	1,166	841
Kolaterali në kesh	(560)	(610)
Kreditë te aksionarët, neto	606	231
	2021	2020
Kreditë bruto te menaxhmenti dhe anëtarët e bordit, bruto	97	129
Lejimet për rënie në vlerë	(1)	
Kreditë te menaxhmenti neto	96	129
Kolaterali në kesh	(32)	(40)
Neto ekspozimi te menaxhmenti	64	89

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për pasqyrat financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

28. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Liabilities:	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<i>Llogaritë bankare me aksionar</i>		
Aksionarët tjerë dhe menaxhmenti	3,433	3,015
Gjithsej	3,433	3,015
Huazimi nga BERZH	6,580	3,098
Gjithsej detyrimet	10,013	6,113

Më poshtë janë shpalosur transaksionet me palët e lidhura gjatë vitit:

	2021	2020
Të ardhurat		
Të ardhurat nga interesi nga kreditë dhe paradhëniet	18	50
Gjithsej të ardhurat	18	50
Shpenzimet		
Shpenzimet e interesit nga huamarrjet prej BERZH	54	39
Kompensimi i menaxhmenti kryesor	553	424
Kompensimi i bordit të drejtorëve	77	58
Gjithsej shpenzimet	684	521

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë EURO, përveç kur specifikohet ndryshe)

29. NGJARJET PASUESE

Asnjë ngjarje ose transaksion nuk ka ndodhur që nga 31 dhjetori 2021 ose nuk është në pritje që do të kishte një efekt material në pasqyrat financiare të Bankës në atë datë ose për periudhën që përfundoi atëherë, ose që kanë një rëndësi të tillë në lidhje me çështjet e Bankës sa i përket kërkojnë përshkruar në një shënim të pasqyrave financiare.

Ndikimi i konfliktit në Ukraine

Konflikti aktual midis Ukrainës dhe Rusisë paraqet një sfidë për institucionet financiare në mbarë botën që operojnë globalisht dhe veçanërisht për ata të ekspozuar ndaj klientëve dhe furnitorëve që janë ose do të bëhen subjekt i sanksioneve.

Konflikti po ndikon në çmimet e energjisë si nafta dhe gazi natyror, si dhe çmimet e ushqimeve dhe mallrave, të cilat duket se do të rrisin më tej nivelin e inflacionit, i cili pritet të zgjasë për një periudhë më të gjatë kohore.

Megjithatë, si bankë vendase, ne nuk jemi të ekspozuar ndaj transaksioneve që lidhen me kompanitë që i nënshtrohen sanksioneve dhe për këtë arsye nuk parashikojmë ndonjë ndikim negativ. Për më tepër, është ende herët për të parashikuar ndonjë ndikim të mundshëm negativ të konfliktit në ekonominë e vendit tonë dhe nuk parashikojmë të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm negativ. Megjithatë, situata mund të çojë në disa ndryshime të vogla të politikave të menaxhimit të rrezikut dhe ndoshta në gjykime shtesë për vlerësimin e rrezikut.

Si e tillë, nuk ka asnjë pasiguri të bankës sonë për aftësinë e saj për të vazhduar si vijimësi.

RAPORTI VJETOR 2021



Banka e vendit tënd

Rr. Ukshin Hoti, nr. 128,
Prishtinë 10000, Kosovë

informat@bpbbank.com
038 620 620 | 0800 50000

www.bpbbank.com